E DREJTA PËR LIRI NË PRAKTIKËN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (2022-2026)

Guidë analitike, sistematike dhe praktike për sistemin gjyqësor shqiptar

Analizë e integruar e faktit, pretendimeve dhe arsyetimit kushtetues në 17 vendime të Gjykatës Kushtetuese (nr. 39/2022 – nr. 57/2026)

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

E DREJTA PËR LIRI NË PRAKTIKËN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (2022-2026)

GUIDË ANALITIKE, SISTEMATIKE DHE PRAKTIKE PËR SISTEMIN GJYQËSOR SHQIPTAR

Analizë e integruar e faktit, pretendimeve dhe arsyetimit kushtetues në 17 vendime të Gjykatës Kushtetuese (nr. 39/2022 – nr. 57/2026)

Përgatiti: Gentian Jahjolli

Council of Europe

Kjo Guidë është përgatitur dhe botuar në kuadër të Projektit të Këshillit të Evropës *"Rritja e kapaciteteve të gjyqësorit për zbatimin më të mirë të standardeve të së drejtës për liri dhe siguri në Shqipëri"* financuar nga Fondi i Mirëbesimit për të Drejtat e Njeriut, i cili bashkon tetë shtete anëtare të Këshillit të Evropës: Finlandën, Gjermaninë, Irlandën, Luksemburgun, Holandën, Norvegjinë, Zvicrën dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Riprodhimi i fragmenteve (deri në 500 fjalë) është i lejuar, përveçse për qëllime tregtare, me kusht që të ruhet integriteti i tekstit, fragmenti të mos përdoret jashtë kontekstit, të mos ofrojë informacione të paplota dhe të mos e çorientojë lexuesin në ndonjë mënyrë tjetër lidhur me natyrën, fushëveprimin ose përmbajtjen e tekstit. Burimi i tekstit duhet të citohet gjithmonë si më poshtë: "© Këshilli i Evropës, viti i botimit". Të gjitha kërkesat e tjera që lidhen me riprodhimin/përkthimin e të gjithë dokumentit ose të një pjese të tij, duhet t'i drejtohen Divizionit të Botimeve dhe Identitetit Vizual, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Çdo korrespondencë tjetër në lidhje me këtë dokument duhet t'i drejtohet Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Bashkëpunimin në fushën e Drejtësisë të Këshillit të Evropës, Këshilli i Evropës, F-67075 Strasbourg Cedex, E-mail: dgi-coordination@coe.int

Ky botim nuk është redaktuar nga Njësia Redaktuese e DPIV-së për korrigjimin e gabimeve tipografike dhe gramatikore.

Përgatiti:
Gentian Jahjolli

Dizajni i kopertinës dhe faqosja: Delta Print Studio

© Këshilli i Evropës, nëntor 2026

PËRMBAJTJA

I. Hyrje dhe metodologjia 7

II. Kuadri kushtetues dhe konventor i të drejtës për liri (Neni 5 KEDNJ i integruar) 9

III. Standardi i "dyshimit të arsyeshëm": kushti *sine qua non* *12*

IV. Llojet e masave të sigurimit dhe regjimet e tyre kohore 16

V. Parimi i proporcionalitetit: testi tre fazësh 22

VI. Arsye të posaçme për zëvendësim ose revokim të masës së sigurimit 26

VII. Garancitë procedurale të së drejtës për liri 29

VIII. E drejta per liri në ndërthurje me të drejta të tjera kushtetuese 36

IX. Kontrolli periodik i masave dhe qëndrueshmëria e arsyetimit 42

X. Legjitimimi (locus standi) në gjykimin kushtetues individual lidhur me masat e sigurimit 45

XI. Testi kushtetues për vendimet lidhur me të drejtën për liri 49

XII. Tabelë përmbledhëse e 17 vendimeve 53

XIII. Përfundime dhe orientime praktike për gjyqtarët 55

I. HYRJE DHE METODOLOGJIA

Kjo guidë ka për qëllim t'i shërbejë sistemit gjyqësor shqiptar, veçanërisht gjyqtarëve të porsaemëruar dhe atyre që merren me çështje penale dhe kushtetuese, si burim referimi sistematik mbi praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë ("Gjykata" ose "GJK") lidhur me lirinë personale, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Guida trajton, gjithashtu, të drejta dhe parime të tjera kushtetuese të lidhura me lirinë personale, në masën që ato janë shqyrtuar në kuadër të vendimmarrjes për masat e sigurimit.

Guida bazohet në analizën integrale të 17 vendimeve përfundimtare të Gjykatës Kushtetuese, të shpallura ndërmjet 15.12.2022 dhe 25.05.2026, të cilat trajtojnë drejtpërdrejt kufizimin e lirisë individuale: nga vendimi nr. 39, datë 15.12.2022 (Komiteti Shqiptar i Helsinkit; vendim mbi kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit, jo ankim kushtetues individual) e deri te vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (çështja e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës). Për secilin vendim janë analizuar në mënyrë integrale rrethanat faktike, pretendimet e kërkuesve, qëndrimet e subjekteve të interesuara (Prokuroria e Posaçme, Kuvendi), si dhe arsyetimi i plotë i Gjykatës, përfshirë mendimet e pakicës dhe qëndrimet e ndara, kur ka pasur të tilla, të cilat në praktikën e fundit të GJK-së kanë luajtur rol të rëndësishëm në evidentimin e çështjeve doktrinarë dhe praktike ende të pazgjidhura.

Në vend të një trajtimi kronologjik vendim-pas-vendimi, guida është organizuar sistematikisht sipas temave/parimeve juridike, në mënyrë që të shërbejë si mjet praktik kërkimi: një gjyqtar që has një çështje konkrete (p.sh. zëvendësim mase për arsye shëndetësore, kontroll periodik i "Arrest në shtëpi", ose përdorim i kabinës prej xhami në sallën e gjyqit) mund të gjejë direkt seksionin përkatës dhe vendimet udhëzuese. Në fund të guidës ndodhet një tabelë përmbledhëse e të 17 vendimeve individuale (Seksioni XII), e dobishme si referencë e shpejtë.

Vlen të theksohet që kjo guidë analizon vetëm vendimet e listuara; nuk pretendon të jetë shteruese e gjithë praktikës kushtetuese mbi lirinë personale (e cila shtrihet përtej periudhës 2022–2026), por fokusohet posaçërisht në këtë bllok vendimesh të viteve më të fundit, i cili pasqyron në mënyrë të pasur zhvillimet më të reja të kësaj jurisprudence, përfshirë disa ndryshime domethënëse të vetë praktikës gjyqësore brenda periudhës së analizuar (shih veçanërisht Seksionin IV.B mbi evolucionin e regjimit të "Arrest në shtëpi").

II. KUADRI KUSHTETUES DHE KONVENTOR I TË DREJTËS PËR LIRI

2.1. Neni 27 i Kushtetutës: aspekti substancial

Neni 27, pika "1", i Kushtetutës parashikon parimin themelor se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Pika "2" e po këtij neni parashikon në mënyrë shteruese rastet e lejueshme të kufizimit, ndër të cilat kryesoret për praktikën e analizuar janë: shkronja "b" (moszbatimi i urdhrave të ligjshëm të gjykatës) dhe shkronja "c" (dyshime të arsyeshme se personi ka kryer vepër penale, ose për të parandaluar kryerjen e veprës penale a largimin e tij pas kryerjes), si dhe shkronja "dh" (ekstradimi/dëbimi).

Gjykata Kushtetuese ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme (vendimet nr. 24/2023, 39/2022, 57/2026, e të tjera) se qëllimi kryesor i nenit 27 është të **parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustifikuar të lirisë**, pasi liria personale është "e një rëndësie jetike për një shoqëri demokratike". Prej këtej rrjedh standardi i "ligjshmërisë" sipas të cilit kushtet për heqjen e lirisë duhen përcaktuar qartësisht në ligj, dhe vetë ligji duhet të jetë i parashikueshëm në zbatim.

2.2. Neni 28 i Kushtetutës, i lidhur me nenin 42: aspekti procedural i të drejtës për liri

Ndërsa neni 27 i Kushtetutës mbron thelbin substancial të lirisë personale, neni 28 (i lidhur me nenin 42, e drejta për proces të rregullt ligjor, dhe me nenin 31, e drejta për mbrojtje) garanton anën procedurale: njoftimin e menjëhershëm të shkaqeve dhe të akuzës; komunikimin e menjëhershëm me avokatin; dërgimin e personit të arrestuar brenda 48 orëve përpara gjyqtarit (pika 2); të drejtën për t'u gjykuar brenda

një afati të arsyeshëm ose të drejtën për t'u proceduar i lirë kundrejt garancisë pasurore (pika 3); të drejtën e ankimit; dhe trajtimin njerëzor e respektimin e dinjitetit njerëzor. Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) sqaron shprehimisht (par. 32) se këto garanci "nuk zbatohen në të njëjtën shtrirje dhe intensitet" si në proceset që vendosin në themel për (pa)fajësinë e individit, kufizimi i tyre në fazën e kontrollit të masës së sigurimit diktohet nga natyra e posaçme, urgjenca dhe objekti i kësaj procedure.

Në vendimin nr. 83/2024 (Malltezi), Gjykata ka formuluar në mënyrë të qartë dallimin konceptual themelor, i cili funksionon si kornizë metodologjike e vetë analizës kushtetuese: "aspekti substancial i lirisë personale duhet analizuar nën dritën e nenit 27 […], ndërsa aspekti procedural i saj duhet analizuar nën dritën e nenit 28 të lidhur me nenin 42 të Kushtetutës. Rregullat procedurale penale që lejojnë kufizimin e lirisë personale i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal, të lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor, ndaj interesi publik është i prezumuar (shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese)".

Kjo strukturë dyfishe (substanciale/procedurale) përsëritet si metodologji standarde në pothuajse të gjitha vendimet e periudhës 2024–2026, përfshirë vendimin më të fundit, 57/2026 (Veliaj, par. 29-30).

2.3. Neni 5 i KEDNJ-së dhe roli i integruar i GJEDNJ-së

Gjykata Kushtetuese ka integruar sistematikisht jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në arsyetimin e saj, duke e trajtuar nenin 5 të KEDNJ-së si pjesë të pandashme të standardit kushtetues të nenit 27 dhe 28 të Kushtetutës. Ndër vendimet më të cituara të GJEDNJ-së në vendimet e analizuara janë: *Buzadji k. Moldavisë* [DHM] (2016), vendimi më i cituar, që trajton testin e rreziqeve të veçanta të procedimit penal dhe standardin e arsyetimit; *Selahattin Demirtaş k. Turqisë* (nr. 2) [DHM] (2020); *Saadi k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHM] (2008); *McKay k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHM] (2006); *Merabishvili k. Gjeorgjisë [DHM] (2017);* si dhe disa vendime shumë të fundit kundër vetë Shqipërisë: *Hysa k. Shqipërisë* (21.02.2023) dhe *Gëllçi k. Shqipërisë* (25.02.2025) , si tregues të qartë të një dialogu të

gjallë e të vazhdueshëm mes GJK-së dhe GJEDNJ-së mbi çështje të lirisë personale në kontekstin shqiptar.

Neni 5, pika 4, KEDNJ : "habeas corpus-i evropian"

Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) sjell një formulim të ri, të qartë dhe të zgjeruar të kësaj dispozite specifike, të cilën e cilëson shprehimisht si "*habeas corpus*-in e KEDNJ-së" (par. 33): çdo person i arrestuar ose i ndaluar ka të drejtën e shqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë së masës, jo vetëm nën dritën e kërkesave ligjore kombëtare, por edhe të vetë KEDNJ-së, parimeve të përgjithshme të shprehura në të, dhe qëllimit të kufizimeve të lejuara nga paragrafi 1 i nenit 5. Ky shqyrtim duhet të garantojë barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, duke i dhënë personit mundësi **efektive** (jo thjesht formale) për të kundërshtuar dyshimet ose akuza, duke përfshirë mundësinë që i ndaluari të dëgjohet personalisht ose përmes përfaqësuesi, si një nga garancitë më themelore të gjithë procesit. Kjo formulë shërben si urë e drejtpërdrejtë lidhëse mes neneve 28 dhe 42 të Kushtetutës dhe standardit konventor, dhe rekomandohet si referencë e parë çdo herë që trajtohet aspekti procedural i lirisë personale.

> **Parim udhëzues:** gjykatat e zakonshme (GJKKO, Gjykata e Lartë) kanë detyrim jo vetëm të zbatojnë KPP-në, por edhe të mbajnë parasysh drejtpërdrejt praktikën gjyqësore të GJK-së dhe të GJEDNJ-së. Në bazë të parimit të subsidiaritetit ky detyrim bëhet edhe më i fortë, pasi Gjykata Kushtetuese e konsideron veten "mjeti i fundit" për mbrojtjen e kësaj të drejte (shih vendimet nr. 1/2025, 81/2024, 7/2026).

III. STANDARDI I "DYSHIMIT TË ARSYESHËM": KUSHTI SINE QUA NON

Neni 228, pika 1, e Kodit të Procedurës Penale (KPP), në zbatim të delegimit të nenit 27(2)(c) të Kushtetutës, përcakton "dyshimin e arsyeshëm" si kusht të domosdoshëm (*sine qua non*) për çdo masë sigurimi. Ky standard është përsëritur si formulë konstante në pothuajse çdo vendim të analizuar (nr. 19/2023, 51/2023, 19/2024, 81/2024, 83/2024, 86/2024, 3/2026, 4/2026, 7/2026, 57/2026).

3.1. Përmbajtja e standardit

Dyshimi konsiderohet "i arsyeshëm" kur bazohet në fakte ose informacione që arrijnë të bindin një vëzhgues të jashtëm dhe objektiv se personi mund të ketë kryer veprën penale, pa qenë e nevojshme që të arrijë nivelin e provës së kërkuar për ngritjen e akuzës ose për dënimin (vendimet nr. 19/2024, 7/2026). Për vlerësimin e dyshimit të arsyeshëm mbahen parasysh statusi/personaliteti i personit, kronologjia e ngjarjeve, mënyra e kryerjes së hetimit dhe sjellja e autoriteteve (vendimi nr. 19/2024, Beleri).

Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) përcakton një aspekt të rëndësishëm mbi **nivelin** e kërkuar të provës në këtë fazë. Gjykata dallon shprehimisht mes "provave" që shërbejnë për vërtetimin e fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (standard i fazës së gjykimit të themelit) dhe "të dhënave, informacioneve ose fakteve apo indicieve objekt prove" që shërbejnë vetëm për krijimin e dyshimit të arsyeshëm në fazën e kontrollit të masës së sigurimit (par. 24).

Kjo do të thotë se pretendimet për papërdorshmëri/pavlefshmëri provash (p.sh. "fruti i pemës së helmuar", deklarata vetinkriminuese) **nuk** trajtohen në këtë fazë kushtetuese, por i mbeten kërkuesit për t'i

ngritur para gjykatave të zakonshme gjatë gjykimit të themelit, parim i rëndësishëm kufizues i objektit të shqyrtimit kushtetues në këtë lloj çështjesh.

Vendimi nr. 57/2026 i GJK përcakton qartë standardin e dyshimit të arsyeshëm dhe kufijtë e kontrollit kushtetues, Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se: **§83: Në zbatim të nenit 27 të Kushtetutës, neni 228, pika 1, i KPP-së e përcakton ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova si kusht të domosdoshëm për caktimin e masës së sigurimit.**[1]

§84: Për të verifikuar dyshimin e arsyeshëm kërkohet një hetim real mbi faktet; vlerësimi duhet të marrë parasysh kontekstin e përgjithshëm, statusin dhe personalitetin e personit, kronologjinë, mënyrën e hetimit dhe sjelljen e autoriteteve.[2]

§§85–87: Prezumimi i pafajësisë kërkon që gjykata të mos nisë vlerësimin nga bindja se personi ka kryer veprën; ndërsa standardi i arsyetimit kërkon një vendim koherent dhe të mjaftueshëm. Gjykata Kushtetuese nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, por ndërhyn kur gjetjet e gjykatave të zakonshme janë arbitrare ose haptazi të paarsyeshme.[3]

§88: Në kontrollin e masës së sigurimit, të dhënat dhe faktet që ishin në dispozicion të autoriteteve në momentin e caktimit duhet të vlerësohen në tërësinë e tyre për të përcaktuar faktin nëse krijonin dyshim të arsyeshëm; garancitë e nenit 27, pika "2", duhet të gëzohen plotësisht pikërisht në momentin e kufizimit të lirisë.[4]

Gjykata ka përcaktuar se në rastin konkret dyshimi nuk ishte mbështetur në vlerësime abstrakte, por në të dhëna, informacione dhe akte konkrete, të cilat, të marra së bashku, krijonin një lidhje objektive midis kërkuesit dhe veprave për të cilat dyshohej. Gjykata nuk ka zëvendësuar vlerësimin e gjykatave të zakonshme në çmuarjen e provave. Ajo ka verifikuar vetëm nëse përfundimi për ekzistencën e dyshimit të

1. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (V-57/26), §83.
2. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (V-57/26), §84.
3. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (V-57/26), §§85–87.
4. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (V-57/26), §88.

arsyeshëm ekzistonte ose jo, nëse ishte arbitrar ose nëse ishte haptazi i paarsyeshëm.

§91: Për masën e sigurimit mjafton që informacionet konkrete, të vlerësuara në tërësi, të jenë të tilla që të bindin një vëzhgues të paanshëm se personi mund të ketë kryer veprën; GJK nuk e zëvendëson gjykatën e faktit në çmuarjen e provave.[5]

3.2. Nevoja e rifreskimit të dyshimit me kalimin e kohës

Praktika më e re (vendimet nr. 3/2026 dhe nr. 4/2026, të dyja lidhur me kontrollin periodik dymujor sipas nenit 246/6 KPP) ka përcaktuar se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm në momentin fillestar **nuk** mjafton më vetvetiu për vazhdimin e masës sigurimit, gjykatat duhet të ushtrojnë "kontroll të përditësuar" dhe "individualizuar", duke trajtuar çdo informacion të ri hetimor si element që ose e konsolidon, ose e zbeh dyshimin ekzistues, jo thjesht duke ripërsëritur formalisht arsyet fillestare.

3.3. Çështje doktrinare ende në diskutim: dyshimi i arsyeshëm përballë vendimit të pafajësisë (jo të formës së prerë)

Vendimi nr. 19/2023 (Agron Laçaj) përfaqëson rastin kryesor të kësaj çështjeje dhe pasqyron një nga debatet doktrinare më domethënëse të vendimeve të analizuara. Shumica e Gjykatës ka vendosur se, për sa kohë vendimi i pafajësisë **nuk** kishte marrë formë të prerë (ishte kthyer për rishqyrtim nga Gjykata e Lartë), i pandehuri "ruan të njëjtin status procedural", prandaj ricaktimi i masës "Arrest në burg" nuk kishte cenuar lirinë personale.

> **Vendimi nr. 19/2023 (Laçaj):** Pakica në mendimin e saj nuk ishte dakord me përfundimin e arritur nga shumica, duke argumentuar se masa fillestare e sigurimit ishte shuar *ipso lege* në bazë të vendimit të pafajësisë (ende e ekzekutueshme sipas nenit 462 KPP, edhe pse jo i formës së prerë), dhe se ricaktimi i masës së sigurimit,

5. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (V-57/26), §91.

> kërkonte analizë të veçantë mbi lidhjen shkakësore mes "dënimit" dhe "burgimit" (duke cituar rastin *Del Río Prada k. Spanjës*, 2013). Pakica ka evidentuar se përjashtimet nga liria kërkojnë interpretim të ngushtë (rasti *Belozorov k. Rusisë/Ukrainës*, 2015) dhe se vazhdimi i masës duhet mbështetur në arsye specifike, jo "të përgjithshme dhe abstrakte" (*Hysa k. Shqipërisë*, 2023).

Ky debat është i rëndësishëm nga ana praktike, sepse gjyqtarët e gjykatave të zakonshme që hasin situata të ngjashme (rikthim çështjeje për rigjykim pas prishjes së vendimit të dënimit, që kishte ndryshuar vendimin e mëparshëm të pafajësisë) duhet të jenë të vetëdijshëm për të dyja qëndrimet dhe të arsyetojnë në mënyrë të posaçme qëndrimin e mbajtur.

3.4. Prezumimi i pafajësisë dhe gjuha e vendimeve gjyqësore

Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) trajton një pretendim të ri, të rëndësishëm nga ana praktike për arsyetimin e vendimeve të masave të sigurimit. Në rastin konkret, kërkuesi pretendoi se përdorimi nga gjykatat i shprehjeve si: "përfitime të parregullta", "pasurim personal" ose "shpërfillje ndaj fondeve publike" në arsyetimin e vendimeve për masën e sigurimit shprehte "bindje të formuar për fajësinë" dhe transferon në mënyrë të padrejtë barrën e provës te i pandehuri. Gjykata Kushtetuese ka trajtuar këtë pretendim të lidhur (jo krejtësisht të veçuar) me standardin e dyshimit të arsyeshëm, duke kërkuar të verifikohet nëse "arsyetimi konkret i gjykatave ka mbetur brenda kufijve të dyshimit procedural, apo nëse është përdorur një gjuhë që shpreh bindje për fajësinë e kërkuesit" (par. 30). Ky test i "gjuhës gjyqësore" përbën një element të ri të arsyetimit kushtetues: në vendimet mbi masat e sigurimit, gjykatat e zakonshme duhet të mbajnë parasysh që formulimet e përdorura të qëndrojnë në rrafshin e "dyshimit" (p.sh. "dyshohet se ka përfituar"), pa shprehur bindje për fajësinë e personit që në momentin e caktimit të masës.

IV. LLOJET E MASAVE TË SIGURIMIT DHE KOHËZGJATJET E TYRE

Një nga kontributet më praktike të vendimeve të analizuara është përcaktimi (dhe evolucioni) i zgjatjeve të kohore të veçanta që zbatohen për lloje të ndryshme të masave të sigurimit. Kjo është një fushë ku gjyqtarët e gjykatave të zakonshme duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm, pasi vetë praktika e GJK-së ka ndryshuar brenda periudhës së analizuar duke krijuar disa standarde të rëndësishme.

4.1. "Arresti në burg": regjimi "bazë" (neni 263 KPP)

Neni 263 KPP përcakton afatet maksimale të masës së sigurimit "Arrest në burg" gjatë periudhës pas dhënies së vendimit të shkallës së parë dhe atij të apelit, të diferencuara sipas rëndësisë së veprës penale (p.sh. gjatë fazës së hetimeve: 3 muaj për kundërvajtje, 6 muaj për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim, 12 muaj për krime që dënohen në maksimum mbi 10 vjet burgim; apo kur dërgohen aktet në gjykatë: dy muaj për kundërvajtje, 9 muaj për krime që dënohen në maksimum deri 10 vjet burgim, dhe 12 muaj për krime që dënohen në maksimum mbi 10 vjet burgim). Vendimi nr. 58/2023 (Mimoza Bruzia) është rasti kryesor mbi këtë temë: Gjykata e Apeli e kishte mbajtur çështjen 18 muaj, në tejkalim të dukshëm të afatit 9-mujor.[6]

> **Vendimi nr. 58/2023 (Bruzia) :** Gjykata Kushtetuese me shumicë votash e ka rrëzuar kërkesën për shfuqizimin e vendimit, duke pranuar shkeljen fillestare, por duke e konsideruar "të korrigjuar" nga fakti që koha e tepërt e paraburgimit u përllogarit më vonë në dënim (neni 465 KPP, neni 57 KP, në raportin një ditë paraburgim baras me 1.5 ditë

6. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 58, datë 13.11.2023.

burgim). Pakica nuk ishte dakord këtë përfundim, me argumentimin se "korrigjimi prapaveprues" nuk shlyen shkeljen kushtetuese të vetë periudhës së kufizimit të paligjshëm; pakica e gjyqtarëve vuri theksin në detyrimin aktiv të prokurorit/gjykatës për kontroll periodik çdo 2 muaj sipas nenit 246/6 KPP, dhe se "ngarkesa e punës" nuk justifikon pasivitet gjyqësor (duke cituar rastin E. k. Norvegjisë, 1990).[7]

4.2. "Arresti në shtëpi": evolucioni i rëndësishëm i praktikës (2024–2025)

Masa e sigurimit "arresti në shtëpi" është, ndoshta, tema me zhvillimin më domethënës brenda periudhës së analizuar, dhe meriton vëmendje të veçantë të gjyqtarëve që gjykojnë këto lloj çështjesh lidhur me këtë masë sigurimi:

Periudha I: "Dyfishi i afateve" (2022–2024)

Praktika fillestare e gjykatave të zakonshme, përfshirë Gjykatën e Lartë, e kishte interpretuar nenin 267/1 KPP në kuptimin që masa e sigurimit "Arrest në shtëpi" i nënshtrohej **dyfishit** të afateve të nenit 263 (p.sh. 18 muaj në vend të 9). Gjykata Kushtetuese nuk u shpreh në themel mbi këtë interpretim as në vendimin nr. 17/2024 (Margjeka I), ku gjeti cenim të së drejtës së aksesit, pasi Gjykata e Lartë kishte vendosur pushimin e çështjes, as në vendimin nr. 83/2024 (Malltezi), ku shqyrtimi lidhej me proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë e masës në raport me nevojën e sigurimit, jo me tejkalimin e afatit.

Në vendimin nr. 17/2024, GJK nuk e vuri vetë në pikëpyetje këtë interpretim në themel (duke u fokusuar jo në vetë interpretimin e afatit, por në të drejtën e aksesit dhe në detyrimin e Gjykatës së Lartë për ta shqyrtuar në themel rastin), duke kthyer çështjen për rishqyrtim.[8]

7. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 58, datë 13.11.2023.
8. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 17, datë 13.03.2024. https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/vendime-perfundimtare-2024/; Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 83, datë 05.12.2024.

Periudha II: *korrigjimi i interpretimit të Gjykatës së Lartë dhe vendosja e standardit të afateve të barasvlershme* ***(qershor 2025)***

Vendimi nr. 40/2025 (Margjeka II): në rigjykim, Gjykata e Lartë ripërsëriti të njëjtin interpretim (dyfishi afateve për arrestin në shtëpi, mbështetur edhe në një citim nga praktika e Kasacionit italian). Këtë herë Gjykata Kushtetuese e **rrëzoi** këtë interpretim, duke vërejtur se neni 237/4 KPP përcakton shprehimisht se "*për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin*". Normë kjo e qartë, por që Gjykata e Lartë, përmes interpretimeve teleologjike/gjuhësore, në fakt kishte "krijuar një normë të re procedurale" duke i dhënë shtetit dyfishin e kohës, në vend që të mbrojë individin nga arbitrariteti. Gjykata Kushtetuese bazoi këtë ndryshim edhe në praktikën e GJEDNJ-së (*Buzadji, Idalov, Razvozzhayev dhe Udaltsov k. Rusisë*) sipas së cilës masa e sigurimit "Arrest në shtëpi" përbën gjithashtu privim lirie dhe i nënshtrohet të njëjtave kritere si "Arrest në burg", përfshirë llogaritjen e afateve maksimale.[9]

PËRFUNDIM: duke filluar nga qershori 2025, standardi i arritur nga Gjykata Kushtetuese është se afatet e masës së sigurimit "Arrest në shtëpi" **barazohen** me ato të "Arrest në burg" (neni 263 KPP), dhe **jo** sa dyfishi i tyre. Ky vendim përbën shembullin më të qartë, brenda vendimeve të analizuara, të korrigjimit të interpretimit të Gjykatës së Lartë mbi afatet e masës "Arrest në shtëpi", dhe duhet mbajtur parasysh si pikë referimi kurdoherë që trajtohet kjo çështje, ku konfirmohet parimi se masa e sigurimit "Arrest në shtëpi", nuk është thjesht një kufizim i lirisë, por një privim i lirisë në kuptimin substancial. Gjykata Kushtetuese ka saktësuar se, për efekt të llogaritjes së afateve maksimale të paraburgimit, këto dy masa janë të barasvlershme në kuptim të kohëzgjatjes së tyre.

9. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 40, datë 17.06.2025.

4.3. Masat "më të lehta" të sigurimit: detyrim paraqitje, ndalim dalje jashtë shtetit, garanci pasurore

Masat e sigurimit sipas neneve 233-234 KPP nuk përbëjnë "heqje lirie" në kuptimin klasik të privimit përmes izolimit nga liria personale dhe për to nuk është e nevojshme autorizimi i Kuvendit në rastin e deputetit, **por** mund të cenojnë proporcionalitetin nëse janë të tepërta në raport me qëllimin e ndjekur prej tyre. Në thelb, këto masa lidhen më shumë me lirinë e lëvizjes (neni 38 i Kushtetutës dhe neni 2 i Protokollit nr. 4 të KEDNJ) sesa me lirinë personale në kuptimin e nenit 27 të Kushtetutës (shih Seksionin 8.2, vendimi nr. 81/2024), prandaj kontrolli i tyre përqendrohet te proporcionaliteti dhe jo te kriteret e heqjes së lirisë. Në vendimin nr. 81/2024 (Berisha) Gjykata Kushtetuese ilustron pikërisht këtë parim. Gjykata Kushtetuese **ka pranuar pjesërisht kërkesën**, duke shfuqizuar **vetëm** masën e sigurimit "Ndalim dalje jashtë shtetit", pasi qëllimet e kësaj mase përmbusheshin tashmë nga masa tjetër ("Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"), duke evidentuar qartë kontrollin "nevojë-për-nevojë" të çdo mase sigurimi në mënyrë individuale me kushtet personale, jo në bllok.[10]

Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) sjell një pretendim të ri lidhur me masën e sigurimit "Garanci pasurore" (neni 236 KPP). Kërkuesi kishte pretenduar se kjo masë do të ishte më proporcionale për vepra penale me natyrë pasurore/financiare, veçanërisht kur dokumentacioni përkatës është tashmë i sekuestruar. GJKKO e kishte refuzuar këtë pretendim, duke arsyetuar se "Garancia pasurore" nuk kënaq shkallën e nevojave të sigurimit e as nuk përputhet me natyrën e veprave penale të përfitimit të parregullt të pasurive/fshehjes së burimit të tyre, çështje që Gjykata Kushtetuese e trajton si pjesë e analizës së proporcionalitetit (shih Seksionin V).

10. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 81, datë 21.11.2024.

4.4. Ekstradimi dhe kufizimi i lirisë personale: regjimi i posaçëm (neni 493 KPP)

Neni 27(2)(dh) i Kushtetutës dhe neni 5/1/f i KEDNJ-së lejojnë kufizimin e lirisë posaçërisht për procedurat e ekstradimit/dëbimit. Vendimi nr. 51/2023 (Ermal/Arben Gjokja) shqyrton këtë çështje në mënyrë të detajuar. Procedura e ekstradimit ka regjim **kohor të posaçëm** lidhur me kohëzgjatjen e masës së sigurimit (neni 493 KPP, i ndryshëm nga neni 263 që parashikon regjimin e përgjithshëm), i lidhur me shterimin e tri shkallëve të gjykimit deri në vendim të formës së prerë.[11].

Vendimi nr. 51/2023 (Gjokja) : Gjykata Kushtetuese me shumicë votash ka rrëzuar kërkesën, duke konsideruar se Gjykata e Lartë veproi brenda funksionit të saj si "gjykatë ligji". Pakica e gjyqtarëve argumentoi duke vërejtur një zbrazëti të rëndësishme ligjore: kur gjykata e shkallës së parë **refuzon** ekstradimin, por nuk vendos asgjë lidhur me masën e sigurimit, dhe ky refuzim miratohet më pas (të paktën pjesërisht) nga Gjykata e Apelit, lind pyetja nëse duhet vazhduar paraburgimi deri sa çështja e ekstradimit të bëhet plotësisht e formës së prerë. Kjo çështje mbetet ende pa përgjigje të qartë përfundimtare në praktikë.

Është e rëndësishme për t'u vënë në pah fakti që GJK konfirmoi detyrimin e saj për të shqyrtuar çështjen **në mënyrë të plotë** edhe pasi personi ishte liruar, duke cituar ndërkohë (rastin *Hysa k. Shqipërisë*, 2023). Ky parim procedural konfirmohet në mënyrë të përsëritur në pothuajse çdo vendim të mëvonshëm mbi legjitimimin e palëve (shih Seksioni X).[12]

11. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 51, datë 18.10.2023.
12. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 51, datë 18.10.2023.

4.5. Ligji penal favorizues dhe e drejta për liri

Vendimi nr. 10/2024 (Kllogjeri): Gjykata Kushtetuese ka sqaruar marrëdhënien mes fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues (neni 29/3 Kushtetutë) dhe lirisë personale. Kur një ligj i ri ul marzhet ligjore të dënimit, individualizimi i ri i dënimit **është çështje ligji** (dhe jo thjesht fakti), pra Gjykata e Lartë ka **detyrimin** (jo thjesht mundësinë diskrecionale) të bëjë vetë rikualifikimin proporcional të dënimit sipas kritereve të nenit 47 KP, dhe jo thjesht të verifikojë nëse dënimi ekzistues është caktuar brenda kufijve të rinj ligjorë.[13]

13. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 10, datë 28.02.2024.

V. PARIMI I PROPORCIONALITETIT : TESTI TREFAZËSH

Përtej ekzistencës së "dyshimit të arsyeshëm" (kusht i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm), Gjykata Kushtetuese kërkon që çdo masë sigurimi të kalojë **testin e proporcionalitetit**. Vendimi nr. 3/2026 (Berisha) artikulon strukturën më të plotë, trefazore, të këtij testi, e cituar edhe nga vendimet nr. 1/2025 dhe 81/2024:

1. (i) Përligjja e kufizimit nën dritën e funksionit të tij mbrojtës.
   A i shërben ndërhyrja realisht qëllimit legjitim të ndjekur?
2. (ii) Cilësia e vlerësimit të brendshëm.
   A ka analizuar gjykata në mënyrë konkrete (jo abstrakte/stereotipe) rrethanat e rastit specifik?
3. (iii) Ashpërsia e kufizimit.
   A është masa e zgjedhur më e lehta e mundshme që arrin qëllimin (parimi i përshkallëzimit)?

Neni 228, pika 3, KPP përcakton tri "rreziqet e veçanta" alternative që, bashkë me dyshimin e arsyeshëm, përligjin masën e sigurimit:

(a) rreziku për prishjen e provave;

(b) rreziku i largimit;

(c) rreziku i kryerjes së veprave të reja penale.

Sipas GJEDNJ-së (*Buzadji* [DHM] 2016, §88, cituar në shumë vendime të analizuara), këto arsye duhet të jenë "relevante" dhe "të mjaftueshme", dhe autoritetet duhet të tregojnë "kujdes të veçantë" (cituar edhe *Gëllçi k. Shqipërisë*, 2025) në zhvillimin e procedimit.

Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se **§104: Masat e sigurimit që kufizojnë lirinë personale duhet të jenë në përpjesëtim me qëllimin legjitim dhe të justifikohen me arsye relevante dhe të mjaftueshme. Analiza e proporcionalitetit përfshin nevojën, përshtatshmërinë dhe ashpërsinë e masës së sigurimit.**[14]

§105: Rreziqet që justifikojnë masën e sigurimit duhet të lidhen me rrethana konkrete të treguara posaçërisht në arsyetim. Për masën e sigurimit "Arrest në burg", gjykata duhet të verifikojë edhe pse çdo masë tjetër është e papërshtatshme në raport me rrezikshmërinë e veçantë të veprës dhe të personit.[15]

Në paragrafin §106, Gjykata Kushtetuese e ka lidhur parimin e proporcionalitetit jo vetëm me lirinë personale, por edhe me të drejtën për t'u zgjedhur, pasi masa e sigurimit mund të prodhojë pasoja mbi ushtrimin efektiv të një funksioni të fituar në zgjedhje. Kjo nuk krijon imunitet nga masa e sigurimit, por e bën pasojën zgjedhore pjesë të analizës kushtetuese të parimit të proporcionalitetit lidhur me përshtatshmërinë e masës së sigurimit.

Gjykata Kushtetuese lidhur me funksionin e Gjykatës së Lartë sa i takon parimit të proprocionalitetit ka përcaktuar se: **§§116–120 Kontrolli i Gjykatës së Lartë duhet të jetë efektiv dhe jo formal. Ai duhet të verifikojë individualizimin e rreziqeve, domosdoshmërinë e masës së sigurimit "Arresti në burg", pamjaftueshmërinë e masave më pak kufizuese të sigurimit dhe ndikimin e masës mbi të drejtën për t'u zgjedhur.**[16]

§§118–119: Statusi publik, funksioni, mundësitë financiare, udhëtimet ose rrezikshmëria e shprehur në mënyrë abstrakte nuk mjaftojnë në vetvete. Ato duhet të lidhen me sjellje konkrete, prova konkrete dhe nevoja aktuale të procedimit penal.[17]

§120: Në një rast ku kërkohet masa e sigurimit "Arresti në burg", gjykata duhet të verifikojë në mënyrë konkrete praninë e rreziqeve

14. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (V-57/26), §104.
15. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (V-57/26), §105.
16. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (V-57/26), §§116–120.
17. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (V-57/26), §§118–119.

procedurale në mënyrë të individualizuar, domosdoshmërinë e masës së sigurimit të kërkuar, pamjaftueshmërinë e alternativave më pak kufizuese dhe efektet e masës mbi të drejtën për t'u zgjedhur.[18]

5.1. Arsyetimi konkret kundrejt arsyetimit "abstrakt dhe stereotip"

Dallimi mes një arsyetimi të pranueshëm dhe njërit të papranueshëm qëndron te **konkretizimi** në raport me rrethanat e faktit. Në rastet e caktimit të masave të sigurimit gjykatat kanë detyrimin për arsyetimin e vendimit.

Vendimi nr. 19/2024 (Beleri) përmban listën më të pasur të citimeve GJEDNJ mbi këtë temë (S*., V. dhe A. k. Danimarkës* 2018*; Witold Litwa k. Polonisë* 2000; *James, Wells, Lee k. MB* 2012; *Ibrahimov and Mammadov k. Azerbajxhanit* 2020; *Tiron k. Rumanisë 2009; Smirnova k. Rusisë* 2003; *Becciev k. Moldavisë* 2005).

Vendimi nr. 4/2026 (Malltezi, rasti i kontrollit periodik) përbën zbatim praktik të rëndësishëm në fushën e arsyetimit të vendimit të masave të sigurimit.

Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar arsyetimin e gjykatave të zakonshme si të mjaftueshëm, sepse ato kishin listuar veprime hetimore **konkrete** (pyetje personash specifikë, verifikime ASHK/tatimore, akte noteriale, ekspertim pajisjesh) si "element i ri" të kontrollit periodik të vlerësimit të masës së sigurimit, jo thjesht ripërsëritje formale të vendimit fillestar. Në po të njëjtën linjë, vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) rithekson (par. 67 dhe 78) se arsyetimi i gjykatave "nuk mund të jetë abstrakt, i përgjithshëm ose stereotip", dhe se argumentet duhet të përmbajnë "referenca për fakte specifike dhe rrethanat personale". Në rastin konkret, GJK e vlerësoi të mjaftueshme referencën ndaj mesazheve konkrete drejtuar hetuesve, praninë e një vartësi gjatë takimeve me dëshmitarë, dhe sjelljen e bashkëshortes pas kontrolleve, si tregues konkretë (jo abstraktë) të rrezikut për prishjen e provave.

18. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (V-57/26), §120.

Pakica, në Vendimin nr. 4/2026 (Malltezi): Ka kritikuar këtë përfundim, duke e konsideruar si fakt të përgjithshëm "element-nga-element". Sipas mendimit të pakicës, rreziku i manipulimit të provave u detajua kryesisht për bashkë-të-hetuarin tjetër, jo për vetë kërkuesin ("kërkuesi përmendet në mënyrë të përgjithshme"). Rreziku i largimit u lidh "vetëm me faktin penal" ose me "dëshirën natyrale për të ruajtur lirinë", formulim tepër i përgjithshëm, pa analizë të personalitetit/pasurive/lidhjeve familjare specifike (kriteret klasike *Buzadji*). Pakica ka arritur në përfundimin se: "një masë sigurimi që nuk përmbush standardet e nevojës dhe proporcionalitetit në momentin e caktimit, nuk mund të legjitimohet përmes vazhdimit formal të saj." Ky kontrast (shumicë/pakicë mbi **të njëjtën** çështje faktike, në procese paralele Berisha/Malltezi) ilustron më së miri sesi standardi teorik i njëjtë mund të zbatohet ndryshe në praktikë, dhe është material i vlefshëm ilustrues për trajnimin e gjyqtarëve mbi cilësinë e kërkuar të arsyetimit të vendimit për caktimin ose vazhdimin e masave të sigurimit.[19]

5.2. Qasje e shprehur në mendimet e pakicës (ende jo e konsoliduar në praktikën e shumicës): mundësia e një kontrolli më të rreptë për masën "Arrest në burg"

Në disa mendime të pakicës të vendimeve të analizuara (vendimet 19/2024 dhe 7/2026) është propozuar një ide e përsëritur, ende e pambështetur nga shumica e GJK sipas së cilës: kur objekti i gjykimit kushtetues është masa e sigurimit "Arrest në burg" (masa më e rëndë e privimit të lirisë, e cila në dukje "përplaset" me prezumimin e pafajësisë), Gjykata Kushtetuese duhet të përdorë kritere kontrolli **më rigoroze** ("*stricter scrutiny*") sesa për vendime të tjera gjyqësore, duke e trajtuar këtë masë si *extrema ratio* me natyrë përjashtimore. Kjo ide nuk përbën ende doktrinë e konsoliduar të shumicës së Gjykatës Kushtetuese, por paraqet një temë të vazhdueshme debati brenda vetë Gjykatës, të cilën gjyqtarët dhe praktikuesit e së drejtës duhet ta njohin.[20]

19. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 4, datë 15.01.2026.
20. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 19, datë 21.03.2024, Vendimi nr. 7, datë 28.01.2026.

VI. ARSYE TË POSAÇME PËR ZËVENDËSIM OSE REVOKIM TË MASËS SË SIGURIMIT

6.1. Arsye shëndetësore (neni 230/2 KPP)

Neni 230, pika 2, KPP ndalon caktimin e "Arrest në burg" ndaj personit në gjendje shëndetësore "veçanërisht të rëndë". Standardi GJEDNJ përkatës (në rastin *Melnik k. Ukrainës*, 2006, §94, cituar në vendimin nr. 40/2024) kërkon vlerësimin trefazësh:

(i) kushtet mjekësore të personit;

(ii) përshtatshmëria e kujdesit mjekësor të disponueshëm në kushtet e institutit të paraburgimit;

(iii) përshtatshmëria e vetë masës së sigurimit në raport me gjendjen shëndetësore.

Vendimi nr. 40/2024 (Koka): Në këtë rast, GJK **rrëzoi** kërkesën për zëvendësimin e masës së paraburgimit me "Arrest në shtëpi" pavarësisht ekspertimit mjekoligjor (urdhëruar nga vetë gjykata) që konkludonte gjendje "veçanërisht e rëndë" dhe rrezik shëndetësor nga izolimi, duke arsyetuar se konkluzioni i ekspertëve nuk është detyrues për gjykatën dhe se autoriteti kompetent për kujdesin shëndetësor në paraburgim është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Pakica e Gjykatës Kushtetuese e ka parë çështjen nga një tjetër kuadër kushtetues, jo thjesht nga këndvështrimi i nenit 27 të Kushtetutës, por edhe nga nenet 28/3, 28/5 (trajtim njerëzor/dinjitet) dhe 25 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor). Pakica ka evidentuar detyrimin pozitiv të shtuar të shtetit për kujdes shëndetësor ndaj personave të privuar nga liria (cit. *Kudła k. Polonisë* [DHM] 2000, *Wenner k. Gjermanisë* 2016, Blokhin k. Rusisë [DHM] 2016), duke rikujtuar faktin e mos-caktimit

të ekspertimit shtesë, kur ekziston një mospajtim të gjykatës me aktin e ekspertimit. Kjo ndarje konceptuale (neni 27 kundrejt neneve 25/28 të Kushtetutës) mund të jetë e dobishme metodologjikisht për kërkesa të ngjashme për arsye shëndetësore.[21]

6.2. Ekzekutimi i plotë i dënimit përmes masës alternative

Vendimi nr. 24/2023 (Burimi): Gjykata Kushtetuese ka pranuar kërkesën në një rast domethënës, pas rekursit të Prokurorisë (i cili mbeti afro 5 vjet pa u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë). Kërkuesit i kishte **përfunduar plotësisht** dënimi i caktuar, përmes një mase alternative dënimi: pezullim i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim (me vënie në provë 3-vjeçare, e konfirmuar edhe zyrtarisht nga Shërbimi i Provës dhe Prokuroria e Kavajës); **por** Gjykata e Lartë, rreth 2 vjet pas përfundimit të dënimit, e ndryshoi vendimin e apelit duke e kthyer dënimin me burgim dhe urdhëruar rikthimin në burg të kërkuesit. GJK vërejti se ky "rikthim", pa marrë parasysh faktin e shlyerjes së plotë të dënimit cenoi lirinë personale (arsyetim i jo i mjaftueshëm i GJL). Mendimi i Pakicës e kritikoi fort këtë vendim të shumicës, duke argumentuar se GJK kishte tejkaluar objektin e kërkesës duke e rikualifikuar vetë pretendimin, dhe se "anomalia" i atribuohej funksionimit të keq të sistemit të drejtësisë (vonesës 5-vjeçare), jo antikushtetutshmërisë së vetë vendimit të GJL. Sipas pakicës, GJK, nuk mund të ushtrojë funksion "caktimi dënimi" për shkak të parimit të ndarjes së pushteteve.[22]

21. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 40, datë 14.05.2024.
22. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 24, datë 27.04.2023.

6.3. Statusi procedural pas shfuqizimit të vendimit të dënimit (kthim çështje)

Kjo temë u trajtua në mënyrë të detajuar në Seksionin III.3 më sipër (shih vendimin nr. 19/2023, Laçaj) mbi debatin doktrinar shumicë/pakicë lidhur me e vendimit të pafajësisë jo të formës së prerë.

6.4. Refuzim i ekstradimit si shkak për shuarjen e masës së sigurimit

Shih Seksionin IV.4 më sipër (vendimi nr. 51/2023, Gjokja) mbi rregullat e posaçme kohore të masave në procedurën e ekstradimit dhe çështjen e pazgjidhur plotësisht të efektit të refuzimit të ekstradimit mbi vazhdimin e paraburgimit.

VII. GARANCITË PROCEDURALE TË SË DREJTËS PËR LIRI

Përtej analizës substanciale (të elementit: dyshimi i arsyeshëm dhe të parimit të proporcionalitetit), Gjykata Kushtetuese ka trajtuar sistematikisht edhe aspekte **procedurale**, të lidhura ngushtë me nenin 28 dhe nenin 42 të Kushtetutës, siç e ka sqaruar shprehimisht në vendimin nr. 57/2026 (Veliaj, par. 33), edhe me nenin 5, pika 4, të KEDNJ-së ("*habeas corpus*-i evropian", shih Seksionin II.3 më sipër). Këto vendime "ndalen vetëm në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete" (qëndrim i përsëritur në vendimet nr. 86/2024, 29/2024, 18/2024, 83/2024, 7/2026, 57/2026) [23].

7.1. E drejta e aksesit në gjykatë dhe standardi i arsyetimit

E drejta e aksesit në gjykatë dhe standardi i arsyetimit të vendimit për masat e sigurimit është ndër pretendimet më të shpeshta në vendimet e analizuara (praktikisht të gjitha vendimet e analizuara e ngrenë këtë lloj pretendimi).

Standardi kërkon që vendimi gjyqësor t'u tregojë palëve se janë dëgjuar dhe t'u japë mundësinë ta kundërshtojnë vendim në një instancë më të lartë (qëndrim i përsëritur, p.sh. vendimi nr.161/2025, i cituar edhe në nr. 40/2025). Rasti më i qartë i shkeljes së këtij standardi është vendimi nr. 17/2024 (Margjeka I), ku Gjykata e Lartë u kufizua në konstatimin formal "nuk ka objekt" (pasi masa e sigurimit ishte shuar nga vendimi i dënimit) pa shqyrtuar në **themel** çështjen nëse afati ishte apo jo tejkaluar GJK vlerësoi se ky refuzim mohonte vetë thelbin e së drejtës për akses [24].

23. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 86, datë 30.12.2024; Vendimi nr. 83, datë 05.12.2024; Vendimi nr. 7, datë 28.01.2026.
24. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 40, datë 17.06.2025; Vendimi nr. 17, datë 13.03.2024.

7.1.1. Arsyetimi i vendimeve lidhur me masat e sigurimit

Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se: **§§86–87: Arsyetimi i vendimit duhet t'u tregojë palëve se janë dëgjuar dhe duhet të jetë koherent e i mjaftueshëm. Në kuadër të parimit të subsidiaritetit, Gjykata e Lartë duhet të shqyrtojë dhe t'u japë përgjigje të shprehur pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs.**

Gjykata ka theksuar se mosdhënia e përgjigjes ndaj një pretendimi kushtetues mund të cenojë njëkohësisht standardin e arsyetimit, të drejtën e aksesit dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial. Në rastin konkret, mungesa e arsyetimit të Gjykatës së Lartë për proporcionalitetin, të drejtën për t'u zgjedhur dhe dinjitetin çoi në pranimin e pjesshëm të kërkesës.

§§132–134: Një pretendim kushtetues i ngritur në rekurs nuk mund të mbetet pa përgjigje. Gjykata e Lartë duhet të japë një qëndrim të shprehur dhe të arsyetuar, veçanërisht kur pretendimi prek lirinë personale, proporcionalitetin, dinjitetin ose të drejtën për t'u zgjedhur.[25]

Në Vendimin nr. 57/2026, Gjykata Kushtetuese ka trajtuar, gjithashtu, garancitë e mbrojtjes lidhur me provat e reja në apel në shqyrtimin e ankimit kundër vendimit mbi masën e sigurimit. Në mendimin paralel të GJK, u theksua nevoja që Gjykata e Lartë të sqaronte bazën ligjore të pranimit të provave të reja dhe nëse mbrojtjes i ishte dhënë mundësi reale dhe efektive për t'u njohur, konsultuar dhe kundërshtuar ato.

Aksesi në dosje voluminoze: testi i "pengesës konkrete" (kontribut i vendimit 57/2026)

Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) trajton në detaje çështjen e aksesit në dosje shumë voluminoze (66 vëllime, afro 400 faqe secili) dhe kohës së kufizuar (disa orë) të lënë në dispozicion të mbrojtjes. Gjykata Kushtetuese ka formuluar një test të qartë (par. 39). Pretendimi për cenim të së drejtës së mbrojtjes për shkak të mungesës së aksesit **nuk** mund të merret në konsideratë nëse individi nuk provon **konkretisht** se

25. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026, §§132-134.

si dhe në çfarë mase mungesa e aksesit e ka penguar realisht ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes, deri në cenimin e vetë thelbit të saj.

Gjykata Kushtetuese ka pranuar se koha e lënë mbrojtjes ishte "e kufizuar në raport me volumin e akteve", po e ka rrëzuar pretendimin sepse mbrojtja e kërkuesit **arriti** të parashtrojë kundërshtime, të paraqesë prova, dhe të ushtrojë ankim efektiv. Në rastin konkret, ushtrimi i ankimit nga mbrojtja, kur ai ka qenë efektiv dhe jo thjesht formal, u konsiderua "element rikuperues" i kufizimit fillestar (cit. vendimin nr. 86/2024). Ky vlerësim varet nga rrethanat e çdo rasti dhe nuk nënkupton se çdo ankim, përfshirë atë thjesht formal, rikuperon kufizimin fillestar. GJK vërejti gjithashtu faktin që koha e kufizuar u kompensua nga mundësia e plotë e paraqitjes së pretendimeve në shkallën e apelit ("cenim i përkohshëm" në një fazë, i "kurueshëm" në fazën pasuese, arsyetim ky i përkrahur edhe nga Gjykata e Lartë, par. 44).

Kabina prej xhami / kafazi i sigurisë në sallën e gjyqit

Për herë të parë, vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) trajton pretendimin se qëndrimi i të pandehurit të izoluar në kabinë prej xhami/kafaz sigurie gjatë seancave gjyqësore cenon të drejtën e mbrojtjes efektive (pamundësi komunikimi konfidencial me mbrojtësin) dhe dinjitetin/prezumimin e pafajësisë (imazh publik negativ).

GJK ka aplikuar një standard të ri, të bazuar drejtpërdrejt në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në rastet *Svinarenko dhe Slyadnev k. Rusisë* [DHM] (2014, §134), duke argumentuar se izolimi në sallë gjyqi mund të cenojë drejtshmërinë e procesit (*fairness*) dhe pjesëmarrjen efektive të të pandehurit në gjykim; *Yaroslav Belousov k. Rusisë* (2016, §§148-154). Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se kabina prej xhami mund të bjerë ndesh me nenin 6(3) (b) të KEDNJ nëse pengon konsultimin konfidencial efektiv me mbrojtësin; duke referuar në rastet *Campbell dhe Fell k. MB* (1984, §99) dhe *Goddi k. Italisë* (1984, §31). Konsultimi me mbrojtësin është parë si element thelbësor i garancisë së "lehtësive" të mbrojtjes.

Prandaj, çdo masë izolimi/kufizimi i kontaktit me mbrojtësin duhet vendosur "vetëm në masën e nevojshme" dhe në "përpjesëtim me rreziqet e një rasti specifik", shqetësimet e sigurisë mund ta justifikojnë përdorimin e kabinave prej xhami, por gjykata duhet të vlerësojë ndikimin e tyre konkret mbi mbrojtjen.

Vendimi 57/2026: GJK ka rrëzuar pretendimin kërkuesit mbi qëndrimin në kabinë xhami, sepse ai nuk provoi **pengesën reale** (asnjë rast konkret refuzimi konsultimi, mungesë udhëzimesh, ose mohim pushimi për konsultim). Kërkuesi ishte i pranishëm, u lejua të deklarojë, dhe kërkesa e mbrojtjes për ta lejuar të qëndronte pranë avokatëve u shqyrtua (edhe pse u rrëzua për arsye infrastrukture).

Barra e provës bie mbi kërkuesin për të treguar pengesë konkrete, jo thjesht ekzistencën e vetë kabinës. Pretendimi për cenim të dinjitetit (imazhi negativ, foto në media) u trajtua ndaras, si çështje e lidhur me nenin 25 Kushtetutës/neni 3 KEDNJ, jo si element autonom i lirisë personale.

7.2. Parimi reformatio in peius (mosrëndimi i pozitës) në gjykimin e masave të sigurimit

Parimi i parashikuar në nenin 425/3 KPP ndalon gjykatën e apelit që të caktojë masë më të rëndë ose të japë cilësim juridik më të rëndë, kur i vetmi apelues është i pandehuri. Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) i Gjykatës Kushtetuese **nuk arriti të konfirmojë** parimin e ndalimit të mosrëndimit të pozitës, pikërisht sepse çështja **nuk** arriti shumicën e kërkuar të votave (shumicë prej 5 gjyqtarësh, neni 133/2 Kushtetutë) duke u krijuar një ndarje e trefishtë mendimeve:

Qëndrimi I (4 gjyqtarë), shprehte mendimin për rrëzimin e kërkesës, me argumentin se neni 248/4 KPP u jep të drejtë të gjitha palëve (përfshi prokurorin) të paraqesin prova gjatë verifikimit të masës edhe në gjykimin në apel. Neni 249/6 KPP lejon miratimin e vendimit "për arsye të ndryshme" nga ato të shkallës së parimi.

Sipas këtij qëndrimi, parimi i mosrëndimit të pozitës mbulon **vetëm** caktimin e një mase **më të rëndë** sigurimi, dhe jo bazën faktike/ligjore të arsyetimit për mbajtjen e së njëjtës masë.

Qëndrimi II (3 gjyqtarë), shprehte mendimin e ndërmjetëm, sipas të cilit duhet ishte gjetur, jo shkelje e drejtpërdrejtë e parimit të ndalimit të *mosrëndimit të pozitës*, por shkelje e së **drejtës për vendim të arsyetuar**

nga Gjykata e Lartë, e cila nuk kishte sqaruar marrëdhënien mes regjimit të posaçëm të nenit 248 KPP dhe dispozitave të përgjithshme të gjykimit në apel.

Qëndrimi III (1 gjyqtar), shprehte mendim kritik sipas të cilit pretendimi lidhet me "logjikën mbrojtëse" të parimit edhe kur **nuk ka rëndim formal** të masës së sigurimit; Gjykata e Lartë duhej të kishte vlerësuar nëse mbrojtjes iu dha mundësi **reale** dhe **efektive** (jo formale) për t'u njohur, konsultuar, kundërshtuar provat e reja **përpara** se të përdoreshin në mënyrë përcaktuese në vendimin për lënien në fuqi të masës së sigurimit.

Meqë asnjë qëndrim nuk arriti shumicën e kërkuar, pretendimi u konsiderua **i rrëzuar**, sipas rregullit të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës (sipas të cilit barazimi, shpërndarja e votave është baras me rrëzimin automatik të pretendimit).

7.3. Paanshmëria: testi subjektiv dhe objektiv

Standardi klasik i paanshmërisë zbaton testet e elaboruara nga GJK (i përsëritur në vendimet nr. 81/2024, 49/2023 (që nuk ka për objekt masat e sigurimit, por trajton parimin e paanshmërisë), nr. 3/2026, 4/2026): Testin **subjektiv** (bindja/interesi personal i gjyqtarit konkret) dhe testin **objektiv** (a ofron gjyqtari/procedura garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të njëanshmërisë, përfshirë "dukjen e jashtme"). Vendimet e analizuara përmbajnë disa shembuj konkretë interesantë të pretendimeve për paanshmëri:[26]

> Në vendimin nr. 19/2023 (Laçaj), pretendimi se i njëjti trup gjykues në gjykatën e apelit që po shqyrtonte themelin e akuzës, u konsiderua kompetent të rivendoste edhe për masën e sigurimit (bazuar në Vendimin unifikues nr. 7/2011 KBGJL), dhe nuk u gjet shkelje e testit objektiv.[27]

26. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 3, datë 15.01.2026; Vendimi nr. 4, datë 15.01.2026.
27. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 19, datë 04.04.2023.

Në vendimet nr. 81/2024 dhe nr. 1/2025 (Berisha), u ngrit pretendimi se gjyqtarja e GJKKO-së ishte shkarkuar nga ish-KLD në 1996 kur atë institucion e kryesonte vetë kërkuesi (President në atë kohë). GJK e trajtoi këtë me kujdes procedural, duke kërkuar domosdoshmërinë e një kërkese **formale** specifike përjashtimi për çdo proces individual (parim i rëndësishëm: mospërsëritja formale e kërkesës në një proces të ri e bën pretendimin të papranueshëm edhe nëse është ngritur më parë në proces tjetër).[28]

Në vendimet nr. 3/2026 dhe nr. 4/2026 (Berisha, Malltezi), u ngrit pretendim i ri që e njëjta gjyqtare ishte **vetë** e dënuar (jashtë vendit) për vepër penale dhe se kjo e diskualifikonte atë si magjistrate. GJK e refuzoi këtë kërkesë në mungesë të një akti zyrtar të organit kompetent (KLGJ) që të ketë ndaluar ushtrimin e funksionit, gjyqtarja ka vepruar në pajtim me ligjin (vendimin nr. 42/2025).[29]

7.4. Pavarësia gjyqësore dhe regjimi i monitorimit sipas ligjit nr. 95/2016

Një çështje me natyrë strukturore dhe të rëndësishme për të gjithë sistemin e drejtësisë anti-korrupsion, janë veçanërisht ajo e monitorimit të telekomunikimeve parashikuar nga nenet 48 - 51 të ligjit nr. 95/2016 që vendosin monitorimin (jo të kufizuar në kohë e hapësirë) të telekomunikimeve të gjyqtarëve/prokurorëve të gjykatave të posaçme (edhe të familjarëve të tyre) nga Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), e cila varet vetë nga Prokuroria e Posaçme: që është, pikërisht, pala që kërkon masat e sigurimit.

> **Vendimi nr. 81/2024 (Berisha):** Në këtë vendim lidhur me ligjin nr. 95/2016**,** GJK ka **pranuar** shqyrtimin incidental të kushtetutshmërisë së dispozitave lidhur me monitorimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjykatave antikorrupsion dhe më pas ka **vlerësuar** se ato **nuk** cenojnë parimin e pavarësisë/paanshmërisë, pasi ligji përmban

28. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 81, datë 21.11.2024; Vendimi nr. 1, datë 17.01.2025.
29. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 3, datë 15.01.2026; Vendimi nr. 4, datë 15.01.2026.

"garanci të mjaftueshme" për mënyrën e realizimit të kontrollit (paragrafët 65 - 77 të vendimit). Ky konstatim është përsëritur më pas si "gjë e gjykuar" (parim i ekonomisë procedurale kushtetuese) në vendimet nr. 86/2024 (Gjoka), 1/2025 dhe 3/2026 (Berisha): sa herë që i njëjti pretendim ngrihet sërish nga i njëjti kërkues, GJK nuk e ka rishqyrtuar, duke iu referuar precedentit të saj[30].

30. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 81, datë 21.11.2024; Vendimi nr. 86, datë 30.12.2024; Vendimi nr. 1, datë 17.01.2025; Vendimi nr. 3, datë 15.01.2026.

VIII. E DREJTA PËR LIRI, E LIDHUR ME TË DREJTA TË TJERA KUSHTETUESE

8.1. E drejta për t'u zgjedhur (neni 45 i Kushtetutës)

Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se **§106: Kur masa e sigurimit ndikon mbi ushtrimin efektiv të një funksioni të fituar në zgjedhje, kjo pasojë duhet të merret në konsideratë në analizën e proporcionalitetit të masës së sigurimit.**[31]

§§116–120, Gjykata ka vërejtur se funksioni publik nuk e përjashton zbatimin e masave të sigurimit. Megjithatë, statusi si funksionar publik nuk mund të përdoret si argument abstrakt për rritjen e rrezikshmërisë. Gjykata e Lartë duhet të lidhë rrezikun me sjelljen konkrete dhe me nevojat aktuale të procedimit, si dhe duhet të vlerësojë ndikimin e masës mbi ushtrimin efektiv të funksionit publik.

> **Vendimi nr. 19/2024 (Beleri):** është rasti i njohur i kandidatit të zgjedhur Kryetar Bashkie në Himarë, i arrestuar 2 ditë para zhvillimit të zgjedhjeve për pushtetin vendor dhe i mbajtur nën masën e sigurimit "Arrest në burg" edhe pas fitores në zgjedhje, duke mos mundur të bëjë betimin e të zgjedhurit vendor. GJK ka pranuar se masa e sigurimit **ka kufizuar** të drejtën për t'u zgjedhur (e cila shtrihet përtej të drejtës për të kandiduar, duke përfshirë të drejtën për të ushtruar funksionin e fituar), **por** e ka vlerësuar si **proporcionale** masën, si pasojë dytësore e kufizimit të justifikuar të lirisë personal. Në këtë rast, Gjykata nuk e trajtoi të drejtën për t'u zgjedhur me një analizë proporcionaliteti të veçantë, por e vlerësoi kufizimin e saj si pasojë dytësore, në kuadër të analizës së proporcionalitetit të masës kufizuese të lirisë personale. Gjykata Kushtetuese ka refuzuar

31. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026 (V-57/26), §106.

> gjithashtu pretendimin e kërkuesit për motivim politik të ndjekjes penale, duke kërkuar provë faktike konkrete (jo thjesht kontekst kohor/politik) të lidhjes mes deklaratave politike dhe procesit penal, ndërkohë që ka vënë theksin për "rritjen e kujdesit të nevojshëm" të autoriteteve në raste të tilla. Mendimi i Pakicës sugjeronte një standard më të rreptë kontrolli pikërisht për shkak të "ndërthurjes organike" mes lirisë personale dhe legjitimitetit demokratik të një organi të zgjedhur.[32]

Funksioni i kryetarit të bashkisë në detyrë nën raport me masën e sigurimit "Arrest në burg"

Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) e trajton këtë çështje nga një këndvështrim më kompleks ndryshe nga rasti Beleri (i arrestuar **përpara** se të merrte mandatin), Veliaj ishte Kryetar Bashkie **në detyrë** (mandat i tretë, që nga 2015) në çastin kur u arrestua. Ai ka pretenduar se paraburgimi i zgjatur (mbi 1 vit) kishte sjellë efektet e një "shkarkimi de facto" dhe "pezullimi de facto" nga funksioni, në kundërshtim me nenin 242 KPP (i cili, sipas tij, ndalon masa sigurimi që cenojnë ushtrimin e mandatit të funksionarëve të zgjedhur) dhe me parimin e autonomisë vendore. Në të njëjtën kohë, Gjykata Kushtetuese me vendimi nr. 66/2025, kishte **shfuqizuar** si antikushtetues vendimin e qeverisë (VKM) për shkarkimin e tij nga detyra e kryetarit të bashkisë, duke "afirmuar" mandatin e tij, si kryebashkiak, por duke krijuar kështu një tension të mundshëm mes dy vendimeve paralele të vetë GJK-së (njëri që duket se mbron mandatin nga shkarkimi administrativ i ekzekutivit, ndërsa tjetri duket se vlerëson nëse paraburgimi mund të vazhdojë të bllokojë de facto ushtrimin e të njëjtit mandati). Subjekti i interesuar (SPAK) ka kundërshtuar çdo lidhje automatike mes arrestit dhe "shkarkimit", duke argumentuar se legjislacioni për vetëqeverisjen vendore (ligji 139/2015, nenet 61-62) nuk e përfshin arrestimi si shkak për mbarimin e mandatit, dhe se një interpretim i kundërt "krijon një formë imuniteti procedural për funksionarët publikë, që nuk parashikohet nga Kushtetuta e ligji". GJK e ka trajtuar këtë pretendim si të përfshirë brenda analizës së parimit

32. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 19, datë 21.03.2024.

të **proporcionalitetit** të masës së sigurimit (pra, jo si shkelje autonome e nenit 242 KPP), duke e referuar në seksionin e proporcionalitetit (Seksioni V) analizën mbi ndikimin e këtij efekti në masën e sigurimit.

8.2. Imuniteti parlamentar procedural (neni 73 i Kushtetutës)

Kjo është, ndoshta, tema me kontributin teorik më të pasur të gjithë vendimeve të analizuara, e trajtuar në thellësi nëpër tri vendime (nr. 81/2024, 1/2025, 3/2026), të gjitha lidhur me kërkuesin Sali Berisha.

Interpretimi i fushëzbatimit të nenit 73/2 të Kushtetutës, "liria" nuk përfshin "lëvizjen"

Çështja kryesore që shtrohet është a kërkohet autorizimi paraprak i Kuvendit për çdo masë kufizuese ndaj një deputeti, apo vetëm ato që masa sigurimi që përbëjnë **heqje lirie** në kuptimin klasik (masa izoluese: arrest në burg/shtëpi)?

Vendimi nr. 81/2024 ka konsoliduar interpretimin **e ngushtë** se përdorimi i termit "liria" në nenin 73/2 të Kushtetutës i referohet ngushtësisht vetëm lirisë personale/fizike sipas përcaktimit të neni 27 të Kushtetutës, dhe nuk përfshin lirinë e lëvizjes sipas nenit 38 të Kushtetutës dhe nenit 2 të Protokollit 4 KEDNJ). Prandaj masat jo izoluese të sigurimit: "Detyrim paraqitje" dhe "Ndalim dalje jashtë shtetit" **nuk** kërkojnë autorizim paraprak të Kuvendit për caktimin e tyre; vetëm masat e sigurimit me natyrë izoluese si **arresti** (**burg/shtëpi**) kërkojnë autorizimin paraprak nga Kuvendi.[33]

> **Vendimi 81/2024:** Mendimi i Pakicës e ka kritikuar këtë lloj interpretimi të ngushtë vetëm për pjesën e masës së sigurimit "Ndalim dalje jashtë shtetit", duke argumentuar rreth një kuptimi më të gjerë të nenit 73/2 të Kushtetutës, si divergjencë e vogël, por domethënëse, brenda vetë shumicës së vendimmarrjes të GJK-së.[34]

33. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 81, datë 21.11.2024.
34. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 81, datë 21.11.2024.

Natyra e imunitetit

Vendimi nr. 1/2025 i GJK shqyrton në mënyrë të plotë natyrën dhe qëllimin e institutit të imunitetit. Imuniteti i deputetit, nuk është privilegj personal i deputetit, por mbron vetë parlamentin dhe funksionimin e tij të papenguar.

Ekziston prezumimi bazë se imuniteti duhet hequr në çdo rast kur s'ka arsye për të dyshuar motivim politik (barra e provës mbi deputetin që pretendon motivim të tillë): cit. *Kart k. Turqisë* [DHM] 2009, Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se §§ 96, 101: imuniteti mbron edhe pakicën parlamentare nga presioni i shumicës: "*fumus persecutionis*", duke cituar gjithashtu raportin e Komisionit të Venecias, CDL-AD(2014)011, sipas të cilit organi parlamentar që vlerëson heqjen e imunitetit nuk duhet të hyjë në themelin e akuzave penale (parimi i ndarjes së pushteteve).[35]

Statusi "viktimë" pavarësisht ndryshimit të mëvonshëm të masës

Ruajtja e statusit "viktimë" pavarësisht ndryshimit të mëvonshëm të masës së sigurimit

Një kontribut i rëndësishëm procedural për zhvillimin e praktikës kushtetuese, në vendimin nr. 1/2025, siç është konfirmuar dhe zgjeruar më tej në vendimet nr. 3/2026 dhe nr. 4/2026) është fakti që nëse një masë më e rëndë e sigurimit zëvendësohet më vonë me një masë më të lehtë ("*in melius*"), kjo **nuk** ia heq automatikisht statusin "viktimë" kërkuesit, sepse ndryshimi vjen nga ndryshim faktik i "nevojave të sigurimit", jo nga **pranimi** i shkeljes nga vetë autoritetet (shih *Hysa k. Shqipërisë*, 2023, §52). Kjo praktikë gjyqësore ndryshon rregullin e "korrigjimit brenda sistemit të zakonshëm" (vendosur si kriter në Vendimin nr. 83/2024, Malltezi), i zbatueshëm kur një gjykatë më e lartë korrigjon një gabim të një gjykate më të ulët, një dallim konceptual ky i hollë, por i rëndësishëm për vlerësimin e legjitimimit (shih Seksionin X).

35. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 24, datë 27.04.2023; Vendimi nr. 39, datë 15.12.2022.

8.3. E drejta për jetë private dhe familjare (neni 36 i Kushtetutës)

Vendimi nr. 83/2024 (Malltezi) trajton një pretendim të veçantë, të papërsëritur në vendime të tjera të analizuara sa i takon kufizimit të komunikimit vetëm me ata që banojnë në shtëpi, nën masën e sigurimit "Arrest në shtëpi", cili u pretendua se ishte i bazuar mbi një dispozitë ligjore e cila që nga viti 2017 ishte e shfuqizuar. Pra, kufizimi i vendosur ishte rrjedhimisht ndërhyrje, jo vetëm e lirisë personale, por edhe e jetës private/familjare (neni 36 i Kushtetutës, neni 8 KEDNJ). Ky pretendim, edhe pse GJK nuk gjeti shkelje autonome të kësaj të drejte (as në 83/2024, as në vendimin nr. 4/2026, u ripërsërit dhe u refuzua për të njëjtat arsye), tregon rëndësinë e kontrollit të vazhdueshëm nga vetë gjykatat e zakonshme mbi bazën ligjore aktuale (të pashfuqizuar) lidhur me kushtet konkrete për zbatimin e masave të sigurimit[36]. Në lidhje me nenin 237 KPP, vërtetë dispozita është ndryshuar në vitin 2017, por pika "2" i njeh gjykatës tagrin ligjor për të përcaktuar mënyrën e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së kësaj mase sigurimi izoluese.

8.4. Liria e shprehjes (neni 22 i Kushtetutës)

Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) adreson një pretendim të ri. Kërkuesi ka pretenduar se ishte "ndëshkuar" (në kuptimin që sjellja e tij u përdor si tregues rreziku për masën e sigurimit) për mesazhe të dërguara hetuesve dhe për postime/komunikime publike, të cilat gjykatat e kishin cilësuar si "fushatë denigruese e intimidimi". Kërkuesi pretendoi para gjykatës se kjo mënyrë krijon "efekt pengues" (*chilling effect*) dhe kriminalizon në mënyrë të papranueshme gjuhën/mendimin. Gjykata Kushtetuese **nuk** e trajtoi këtë si pretendim në mënyrë autonome, ajo e vlerësoi atë të përthithur brenda analizës së parimit të proporcionalitetit të masës sigurimit, duke e lidhur me vlerësimin e rrezikut për prishjen e provave (sipas testit nëse përbën sjellja e referuar një tregues objektiv rreziku, apo thjesht ushtrim i lirisë së shprehjes). Sipas GJK e drejta substanciale

36. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 83, datë 05.12.2024;Vendimi nr. 4, datë 15.01.2026.

"tjetër" nuk u shqyrtua me një test të veçantë proporcionaliteti, por u vlerësua si element i peshimit në analizën e proporcionalitetit të masës kufizuese të lirisë; kjo qasje mund të zhvillohet më tej në praktikën e ardhshme të Gjykatës.

IX. TESTI KUSHTETUES PËR VENDIMET LIDHUR ME TË DREJTEN PËR LIRI

Neni 246, pika "6", KPP vendos detyrimin sipas të cilit çdo 2 muaj nga zbatimi i vendimit të masës së sigurimit, prokurori duhet të informojë me shkrim gjykatën për hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit; gjykata, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës. Ky mekanizëm ka qenë objekt i drejtpërdrejtë i dy vendimeve të fundit nga ato të analizuara (nr. 3/2026 dhe nr. 4/2026, respektivisht për rastin Berisha dhe Malltezi, të dy lidhur me të njëjtin procedim penal) [37], si dhe, indirekt, i vendimit nr. 14/2025 brenda çështjes 57/2026 (Veliaj) , verifikimi i vazhdimit të masës vetëm 2 ditë pas caktimit masës fillestare).

Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj ka përcaktuar se: **§§116-120, Kontrolli i Gjykatës së Lartë mbi masat e sigurimit duhet të jetë real dhe efektiv. Nuk mjafton të deklarohet se gjykatat e faktit kanë arsyetuar vendimin; duhet të verifikohet në mënyrë konkrete nëse arsyetimi i tyre përmbush kërkesat kushtetuese të proporcionalitetit dhe nëse i përgjigjet pretendimeve thelbësore të mbrojtjes.**

9.1. Vendimet e ndërmjetme periodike si "vendime përfundimtare" për efekt kontrolli kushtetues

GJK ka konfirmuar (në të dy vendimet nr. 3/2026 dhe nr. 4/2026) se, pavarësisht natyrës periodike të ndërmjetme dhe jo-përfundimtare të këtyre vendimeve brenda procesit penal të zakonshëm, ato konsiderohen "vendime përfundimtare" në kuptim të nenit 131(1)(f) të Kushtetutës, sepse: (i) shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë

37. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 3, datë 15.01.2026; Vendimi nr. 4, datë 15.01.2026.

e vendimit; (ii) vendimi është ankimuar në të gjitha shkallët; (iii) vendimi ka autonomi nga procesi i themelit (pasojat nuk mund të riparohen më vonë nga vendimi përfundimtar mbi fajësinë).

9.2. "Kontroll i përditësuar" kundrejt "ripërsëritjes formale"

Standardi kryesor i kontrollit periodik lidhur me vijueshmërinë e masave të sigurimit përcakton se gjykatat **nuk** duhet të mjaftohen me ripërsëritje automatike të arsyeve fillestare të vendosura në çastin e caktimit të masës fillestare të sigurimit, ato duhet të kryejnë kontroll të individualizuar e të përditësuar të nevojës së vazhdimit të masës së sigurimit, duke trajtuar çdo informacion të ri hetimor mbi veprimet e kryera nga prokurori si element konkret vlerësimi. Krahasimi mes vendimeve nr. 3/2026 dhe nr. 4/2026, që ishte lidhur me **të njëjtin** procedim penal, të njëjtën kohë, dhe pjesërisht të njëjtën gjyqtare të hetimit paraprak, por me trajtim të ndryshëm nga vetë Gjykata Kushtetuese (bazuar në cilësinë konkrete të arsyetimit të gjykatave të zakonshme për secilin nga të dy kërkuesit) tregon qartë se standardi kërkon analizë individualizuar edhe kur bëhet fjalë për bashkë-të-pandehur në të njëjtin procedim.[38]

9.3. Barazimi i votave në seancë plenare: pasoja procedurale

Vendimi nr. 4/2026 trajton një fakt të rëndësishëm procedural mbi vendimin nr. 83/2024 sa i takon pretendimit për respektimin e parimit të proporcionalitetit (jo për dyshimin e arsyeshëm).

GJK "nuk arriti numrin e kërkuar të votave" (shumica prej 5 gjyqtarësh, sipas nenit 133/2 Kushtetutë dhe nenit 72/2 Ligji Organik për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese). Sipas rregullit të zbatuar, kur nuk formohet shumica e kërkuar, pretendimi konsiderohet **i rrëzuar** (jo "i pavendosur" apo "i pashqyrtuar").

Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) konfirmon dhe ilustron më tej këtë rregull (par. 64, 77, bazuar në nenin 73/4 të Ligjit Organik), duke treguar një

38. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 3, datë 15.01.2026; Vendimi nr. 4, datë 15.01.2026.

ndarje të trefishtë të votave (4-3-1) mbi vlerësimin e pretendimit për parimin "reformatio in peius", ku secili grupim e vlerëson në mënyrë të ndryshme pasojën juridike të debatit juridik (shih Seksionin VII.2). Ky rast tregon se mekanizmi i "votës së pamjaftueshme që sjell rrëzimin e kërkesës" nuk kufizohet vetëm në ndarje binare shumicë/pakicë, por vlen edhe kur gjyqtarët ndahen në më shumë se dy grupe interpretuese. Ky është një parim praktik i rëndësishëm për kuptimin e funksionimit të vendimmarrjes kolegjiale të GJK-së.[39]

39. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 4, datë 15.01.2026; Vendimi nr. 83, datë 05.12.2024.

X. LEGJITIMIMI (LOCUS STANDI) NË GJYKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL LIDHUR ME MASAT E SIGURIMIT

Çështja e legjitimimit është analizuar sistematikisht, si hap i parë, në çdo vendim, sipas kritereve kumulative të nenit 71/a të ligjit organik për organizimin dhe funksionimin e GJK nr. 8577/2000: (a) legjitimimi ratione personae; (b) shterimi i mjeteve juridike efektive; (c) legjitimimi ratione temporis (afati 4-mujor); (d) legjitimimi ratione materiae.

10.1. Detyrimi i shqyrtimit të ankimit edhe pas lirimit/ndryshimit të masës: parimi i rastit Hysa

Parimi më i përsëritur i gjithë vendimeve të analizuara (i pranishëm në të paktën 6 nga 17 vendimet e analizuara në detaj, përkatësisht nr: 51/2023, 17/2024, 40/2025, 1/2025, 3/2026, 4/2026), duke cituar rastin *Hysa k. Shqipërisë* (2023, §83; dhe §52 për statusin "viktimë"), përcakton se GJK ka detyrim të shqyrtojë çështjen **në themel** edhe nëse kërkuesi nuk është më nën masën e kundërshtuar (pasi është liruar, ose masa është zëvendësuar me një më të lehtë), sepse "një shqyrtim i plotë *post factum* mund të çojë në konstatimin se kërkuesi u mbajt në kufizim lirie në shkelje të së drejtës për liri". Kjo ka interes edhe për çështjen e kompensimit eventual sipas nenit 5/5 KEDNJ dhe nenin 27 e 28 të Kushtetutë[40]. Parimi nuk zbatohet në të njëjtën mënyrë kur shkelja e pretenduar është njohur dhe riparuar brenda sistemit të zakonshëm gjyqësor, pra kur gjykata ka pranuar shkeljen e pretenduar dhe e ka rikuperuar atë (shih rregullin e "korrigjimit brenda sistemit" në Seksionin 10.2).

40

10.2. Prania e dy rregullave të ndryshme për "korrigjimin" e shkeljes së ndodhur më parë

RREGULLI I "KORRIGJIMIT BRENDA SISTEMIT": Sipas vendimi nr. 83/2024 të GJK kur një shkallë më e lartë (p.sh. Apeli) **korrigjon** vetë gabimin/shkeljen e bërë në një shkallë më të ulët (p.sh. duke ndryshuar masë e sigurimit nga "Arrest në burg" në "Arrest në shtëpi" për shkak të gabimit në vlerësimin e rreziqeve procedurale), ankimi kundër vendimit fillestar (tashmë të korrigjuar) bëhet **i papranueshëm** sepse "pasojat janë riparuar brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm"[41].

RREGULLI I " RUAJTJES SË STATUSIT VIKTIMË": Sipas vendimeve nr. 1/2025, 3/2026, 4/2026, kur një masë më e rëndë sigurimi zëvendësohet **më pas** me një masë sigurimi më të lehtë, **për shkak të ndryshimit të nevojave të sigurimit** (pra, jo për shkak të pranimit të një gabimi/shkeljeje), kërkuesi **ruan** statusin e "viktimës" dhe GJK e shqyrton në themel ankimin kundrejt vendimit fillestar[42].

Dallimi mes këtyre dy rregullave (korrigjim i gabimit kundrejt ndryshimit të mëpasshëm të nevojave të procedimit penal) është element i rëndësishëm dhe relevant që kërkon një analizë të kujdesshme rast pas rasti nga vetë GJK, por që duhet të kihet parasysh edhe gjatë hartimit të vendimeve apo kërkesave për kushtetutshmëri lidhur me lirinë personale.

10.3. Shterimi i mjeteve: domosdoshmëria e ngritjes formale në substancë

Rregulli strikt, i zbatuar në disa vendime (nr. 81/2024, 3/2026, 4/2026, dhe rikonfirmuar në vendimin nr. 57/2026), kërkon që pretendime si: mosdiskriminimi/motivimi politik, ose barazia para ligjit, duhet të ngrihen në ankimin pasues. Në rastet në fjalë, pretendimet e mësipërme, u konsideruan të **papranueshme,** sepse nuk ishin ngritur shprehimisht

41. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 83, datë 05.12.2024.
42. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 1, datë 17.01.2025; Vendimi nr. 3, datë 15.01.2026; Vendimi nr. 4, datë 15.01.2026.

(as në substancë) në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, pavarësisht se ishin ngritur më parë në shkallë më të ulëta të gjyqësorit.

Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj, par. 22) e konfirmon zbatimin e këtij rregulli në mënyrë veçanërisht të qartë, duke përcaktuar se pretendimi për shkelje të parimit të barazisë para ligjit "nuk është ngritur më parë në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, as në formë, as në përmbajtje. Për rrjedhojë […] nuk mund të merret në shqyrtim".

Ky standard vlen edhe për kërkesat e përjashtimit të gjyqtarit, kërkesa duhet ngritur **formalisht** si kërkesë e veçantë përjashtimi **për çdo proces** individual, edhe nëse i njëjti fakt/shkak është përdorur më parë në një proces tjetër paralel (shih vendimet nr. 81/2024, 83/2024).[43]

10.4. Kufizimi kohor i objektit të kontrollit kushtetues: vetëm për fakte objekt të vendimit fillestar

Vendimi nr. 57/2026 (Veliaj) paraqet një sqarim të ri, praktik, në lidhje me aspektin kohor të objektit të gjykimit kushtetues (par. 23). Kur objekt i gjykimit janë vendimet që kanë caktuar/vleftësuar/lënë në fuqi masën **fillestare** të sigurimit, pretendimet ankimore të kërkuesit që mbështeten mbi rrethana faktike dhe zhvillime procedurale të **mëpasshme** (p.sh. përfundimi i hetimeve, dërgimi i çështjes në gjyq, kohëzgjatja e mëtejshme e paraburgimit) **nuk** mund të paraqiten drejtpërdrejt për herë të parë në atë gjykimin kushtetues, edhe nëse lidhen me të njëjtat të drejta kushtetuese, ato duhet së pari të shterohen para gjykatave të zakonshme si pretendime të veçanta.

Ky përfundim përbën një kufizim i rëndësishëm praktik lidhur me pranueshmërinë e kërkesës ankimore. Kërkuesit nuk mund ta "zgjerojnë" objektin e kontrollit kushtetues, duke shtuar në ankim zhvillime të reja (vendime gjyqësore) që nuk kanë qenë pjesë e vendimeve fillestare objekt të kërkesës kushtetuese.

43. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 81, datë 21.11.2024; Vendimi nr. 3, datë 15.01.2026; Vendimi nr. 4, datë 15.01.2026; Vendimi nr. 83, datë 05.12.2024.

XI. TESTI KUSHTETUES PËR VENDIMET LIDHUR ME TË DREJTËN PËR LIRI

Sistemi shqiptar i mbrojtjes së lirisë personale ndaj masave të sigurimit operon nëpërmjet dy niveleve të ndryshme dhe plotësuese: (i) Gjykata e themelit , instanca e faktit dhe e ligjit penal, dhe (ii) Gjykata Kushtetuese, instanca e të drejtës kushtetuese dhe mbrojtëse e maksimumit të mbrojtjes. Dallimi mes këtyre dy roleve është thelbësor për përcaktimin e objektit të kontrollit kushtetues: Gjykata Kushtetuese nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk zëvendëson vlerësimin e faktit nga gjykatat e zakonshme, por ndërhyn kur kufizimi i lirisë rezulton arbitrar, i paarsyetuar ose joproporcional. Testi analitik që pason është një skemë e hartuar nga autori për qëllime sistematizimi, mbi bazën e kritereve që rrjedhin nga praktika e Gjykatës Kushtetuese dhe nga standardet e nenit 5 KEDNJ; ai nuk është formuluar si i tillë nga vetë Gjykata Kushtetuese dhe nuk duhet lexuar si citim i drejtpërdrejtë i jurisprudencës së saj.

TESTI KUSHTETUES I TË DREJTËS PËR LIRI

(SKEMË ANALITIKE SIPAS ANALIZËS DHE STANDARDEVE)

Nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës · Gjykata Kushtetuese përkundër Gjykatës së themelit · Testi me 9 hapa

HAPI	ELEMENTI KUSHTETUES	ÇËSHTJA KUSHTETUESE	GJYKATA E THEMELIT Vlerëson Faktet dhe ligjin penal	GJYKATA KUSHTETUESE Kontrollon Procesin dhe të drejtat kushtetuese
GRUPI I - PARAKUSHTET THEMELORE (Nenet 27/1 dhe 27/2)				
1	**LIGJSHMËRIA E NDËRHYRJES:** Arrestim, ndalim, caktim masa sigurimi, etj. *Neni 27/1*	*A ka masa e sigurimit bazë ligjore substancial e procedurale të qartë, të saktë, të aksesueshme dhe të parashikueshme nga individi?*	Zbaton normën ligjore ekzistuese ndaj fakteve konkrete. Interpreton e aplikon normën sipas KPP, fakteve konkrete dhe provave të administruara.	Verifikon cilësinë e normës si kategori kushtetuese: A është e qartë? A lejon arbitraritet? A mund ta parashikojë individi pasojat? Aspekte që nuk përfshihen në zbatimin e normës.
2	**QËLLIMI LEGJITIM** *Neni 27/2*	*A shërben masa njërit prej tre qëllimeve kushtetuese:* *(a) ekzekutimi i vendimit;* *(b) paraqitja para organit;* *(c) parandalimi i rrezikut?*	Përcakton qëllimin konkret bazuar në provat e hetimit dhe nevojat procedurale. Ka ligjërisht 'hapësirë vlerësimi' brenda katalogut të nenit 27/2 të Kushtetutës.	Kontrollon nëse qëllimi i deklaruar bie brenda katalogut të bbyllur të nenit 27/2. Nëse masa ndjek qëllim tjetër (presion, ndëshkim paraprak) → SHKELJE.
3	**DYSHIMI I ARSYESHËM** *Neni 27/2 + 30*	*A ekziston material faktik i dokumentuar dhe i verifikueshëm që arsyeton dyshimin? (BAZË objektive- jo thjeshtë bindje, dhe jo fajësi)*	Vlerëson nëse provat e paraqitura arrijnë nivelin *'prima facie'* për dyshim të arsyeshëm. Peshon besueshmërinë dhe ligjshmërinë e provave . Kompetencë ekskluzive.	Verifikon vetëm ekzistencën e kategorisë: a ka material faktik të identifikueshëm? NUK peshon provat. Nëse dyshimi ngatërrohet me fajësi → SHKELJE e nenit 30 (prezumimi pafajësisë).

GRUPI II - KUSHTET SUBSTANCIALE (Nenet 17 dhe 27)				
4	**PËRSHKALLËZIMI I MASAVE TË SIGURIMIT** *Nenet 17 dhe 27*	*A ka filluar gjykata nga masa më e lehtë dhe a është ngjitur me arsyetim specifik drejt masës më të rëndë?*	Vlerëson cilën masë specifike e kërkon rasti bazuar në rreziqet e identifikuara. Ka të drejtën të kalojë direkt te masa e rëndë vetëm me arsyetim të plotë e të detajuar.	Kontrollon METODËN dhe, kur është e nevojshme, edhe rezultatin: nëse interpretimi dhe zbatimi i ligjit ka sjellë një kufizim arbitrar ose joproporcional të së drejtës kushtetuese (shih vendimin 40/2025): a ka ndodhur procesi i gradualitetit? Nëse vendimi hesht mbi arsyet e kapërcimit të shkallëve → SHKELJE e dokumentueshme direkt.
5	**DOMOSDOSHMËRIA** *Nenet 17 dhe 27*	*A është masa e zgjedhur e domosdoshme? A mund të arrihet qëllimi kushtetues me një masë alternative më pak kufizuese?*	Ka detyrimin procedural të 'shterimit të alternativave': Të arsyetojë pse secila masë alternative sigurimi (paraqitje, ndalim dalje, arrest shtëpie, garanci) është e pamjaftueshme.	Verifikon nëse arsyetimi i refuzimit të alternativave EKZISTON në vendim si element material. Heshtja mbi alternativat = SHKELJE e verifikueshme pavarësisht saktësisë materiale.

GRUPI III - STANDARDI I ARSYETIMIT (Nenet 28 + 42)				
6	**INDIVID-UA-LIZIMI I ARSYETIMIT** *Neni 28 + 42*	*A është arsyetimi specifik dhe individual për personin konkret. Jo formulë standarde, jo kopjim nga prokuroria, jo referencë kategorike?*	Ndërton arsyetimin individual bazuar në provat, karakteristikat personale, historikun e sjelljes, rrezikun real dhe konkret të personit specifik.	Kopjimi fjalë-për-fjalë i prokurorisë = tregues i mungesës së arsyetimit të individualizuar, që mund të përbëjë shkelje. Formula 'duke pasur parasysh natyrën e veprës...' pa elementë individualë = mund të ngrejë çështje në këndvështrim të nenit 42. GjK është gjyqtari i 'cilësisë së arsyetimit'.
7	**AKTUALITETI (Ri-arsyetimi Periodik)** *Neni 27 + 28*	*A i korrespondon arsyetimi rrethanave AKTUALE dhe jo atyre të momentit të caktimit fillestar (të masës fillestare)? Sa më gjatë masa, aq më i rritur standardi?*	Ka detyrimin e rishikimit aktual të kushteve sa herë masa konfirmohet. Rishikimi duhet të jetë i pavarur nga prokuroria, bazuar në provat e fundit të disponueshme.	Sa më gjatë zgjat masa, aq më i fortë bëhet detyrimi për një vlerësim aktual, konkret dhe të individualizuar të arsyeve që justifikojnë vazhdimin e privimit të lirisë, duke mbajtur parasysh edhe kohëzgjatjen e masës. Referimi vetëm te arsyet e vendimit fillestar, pa vlerësim aktual, mund të ngrejë çështje në këndvështrim kushtetues.

GRUPI IV - PROPORCIONALITETI (Nenet 17 dhe 27)				
8	**PROPORCIONALITETI (Balanca)** *Nenet 17 dhe 27*	*A ekziston balancë midis rëndësisë së kufizimit të lirisë dhe rëndësisë së qëllimit? A janë vlerësuar rrethanat personale (shëndeti, familja, profesion, etj.)?*	Kryen vlerësimin material: peshon rëndësinë e qëllimit të sigurimit kundrejt kufizimit të lirisë. Merr parasysh shëndetin, fëmijët, profesionin, historikun e paraqitjes.	Verifikon nëse balanca si OPERACION LOGJIK ka ndodhur dhe nëse të drejtat konkurruese (neni 54 fëmijë; neni 55 shëndet; neni 22 liria e shprehjes) janë adresuar. Nëse injorohen → SHKELJE.
GRUPI V - KONTROLLI EFEKTIV (Nenet 28/4 dhe 31)				
9	**HABEAS CORPUS KUSHTETUES** *Neni 28/4 + 31*	*A ka pasur individi akses EFEKTIV (jo vetëm formal) te mjeti juridik përkatës? A ka pasur akses efektiv te mbrojtësi dhe dosja hetimore?*	Garanton aksesin procedurial sipas KPP: dëgjimin real të palëve, shqyrtimin e provave të mbrojtjes, mundësinë e kundërshtimit real të kërkesës së prokurorisë.	Nëse kontrolli i themelit ka qenë thjesht formal → GjK aplikon doktrinën e 'mjetit të paefektshëm' dhe shqyrton çështjen. Aksesi te avokati brenda 24h dhe dosja brenda 72h janë standard kushtetues minimal.

DËSHTIMI NË SECILIN HAP MUND TË SJELLË SHKELJE KUSHTETUESE -

GjK kontrollon kryesisht PROCESIN dhe cilësinë e arsyetimit, pa zëvendësuar gjykatën e faktit; ndërhyn edhe kur zbatimi i ligjit çon në kufizim arbitrar ose joproporcional **- Gjykata Penale kontrollon FAKTET dhe LIGJIN PENAL**

NENI 5 KEDNJ = MINIMUMI i detyrueshëm · NENET 27–28 KUSHTETUTA = MAKSIMUMI i garantuar · Liria është rregulli - kufizimi është përjashtimi

XII. TABELË PËRMBLEDHËSE E 17 VENDIMEVE TË ANALIZUARA

Tabela më poshtë ofron referencë të shpejtë për të gjitha vendimet e analizuara (me përjashtim të vendimit nr. 39/2022, që ka për objekt kontrollin e një ligji dhe jo ankim kushtetues individual), me temën kryesore dhe rezultatin e secilit, sipas rendit kronologjik.

Nr. / Datë	Kërkues	Tema kryesore	Rezultat
19/2023 04.04.2023	A.L.	Dyshim i arsyeshëm pas vendimi pafajësie jo të formës së prerë	Rrëzim (shumicë) + Pakicë
24/2023 27.04.2023	K.B.	Ekzekutim dënimi pas shlyerjes së plotë përmes mase alternative	Pranim (shumicë) + Pakicë
51/2023 18.10.2023	E.A.Gj.	Regjim i posaçëm kohor i masës në procedurën e ekstradimit	Rrëzim (shumicë) + Pakicë
58/2023 13.11.2023	M.B.	Tejkalim afati (neni 263 KPP) - "Arrest në burg" gjatë gjykimit	Rrëzim (shumicë) + Pakicë (4 gjyq.)
10/2024 28.02.2024	K.K.	Ligj penal favorizues - rikualifikim dënimi	Pranim (njëzëri)
17/2024 13.03.2024	M.M.	Afati i "Arrest në shtëpi" - e drejta e aksesit	Pranim (njëzëri)
19/2024 21.03.2024	Dh.A.B.	E drejta për t'u zgjedhur; motivim politik i ndjekjes	Rrëzim (shumicë) + Pakicë
40/2024 14.05.2024	L.K.	Arsye shëndetësore - zëvendësim mase	Rrëzim (shumicë) + Pakicë (4 gjyq.)
81/2024 21.11.2024	S.B.	Imuniteti parlamentar (neni 73); ligji 95/2016	Pranim i pjesshëm + Pakicë

Nr. / Datë	Kërkues	Tema kryesore	Rezultat
83/2024 05.12.2024	J.M.	Korniza analitike proceduriale/substanciale; jetë familjare	Rrëzim (pjesa proporc. pa shumicë)
86/2024 30.12.2024	P.Gj.	Prova digjitale ndërkufitare (Sky ECC); res judicata mbi ligjin 95/2016	I pjesshëm [të plotësohet: pjesët e pranuara/rrëzuara dhe votimi, njëlloj si te rreshti 57/2026]
1/2025 17.01.2025	S.B.	Natyra dhe qëllimi i imunitetit parlamentar; statusi "viktimë"	Rrëzim (shumicë)
40/2025 17.06.2025	M.M. (II)	RRËZIM I PRAKTIKËS SË VJETËR mbi afatet e "Arrest në shtëpi"	Pranim (NJËZËRI) - vendim udhëheqës
3/2026 15.01.2026	S.B.	Kontroll periodik (neni 246/6 KPP); test trefazor proporcionaliteti	Rezultat i ndryshëm nga 4/2026 (shih Seksionin 9.2) [të plotësohet: pranim/ rrëzim dhe votimi]
4/2026 15.01.2026	J.M.	Kontroll periodik; barazim votash; kritikë pakice element-nga-element	Rrëzim (shumicë) + Pakicë
7/2026 28.01.2026	I.B.	Kualifikim i ri juridik nga gjykata; siguri juridike; standard kontrolli i diferencuar	Rrëzim (shumicë) + Pakicë
57/2026 25.05.2026	E.V.	Neni 5/4 KEDNJ; kabinë xhami; reformatio in peius (votim trepalësh); e drejtë për t'u zgjedhur (kryetar në detyrë)	I pjesshëm - proced. rrëzuar (pa shumicë); substanciale: shih shënim

XIII. PËRFUNDIME DHE ORIENTIME PRAKTIKE

Nga analiza integrale e vendimeve, mund të nxirren përfundimet e mëposhtme praktike, të dobishme si "listë kontrolli" e shpejtë për juristët që merren me masat e sigurimit. Orientimet e mëposhtme paraqiten si elemente që duhen mbajtur parasysh në praktikë, dhe jo si detyrime të përcaktuara drejtpërdrejt nga Gjykata Kushtetuese.

Për gjyqtarët e shkallës së parë dhe apelit

- Gjykatat duhet të mbajnë parasysh nevojën për një vlerësim konkret dhe të individualizuar të kritereve të parashikuara në nenin 228, pika 3, të KPP-së, në varësi të rrethanave të çështjes dhe shkaqeve mbi të cilat mbështetet masa e sigurimit. Një arsyetim i përgjithshëm ose formal, që nuk evidenton rrethanat konkrete që përligj masën, mund të ngrejë çështje në këndvështrim të standardeve kushtetuese të arsyetimit dhe proporcionalitetit.
- Të tregohet kujdes në përdorimin e formulimeve në arsyetim: formulime si "ka përfituar" ose "ka pasuruar" (në vend të "dyshohet se ka përfituar") mund të lexohen si shprehje e bindjes për fajësinë dhe të ngrenë çështje në këndvështrim të prezumimit të pafajësisë (vendimi 57/2026).
- Gjatë kontrollit periodik të masës së sigurimit (neni 246/6 KPP), të mbahet parasysh nevoja për të mos u kufizuar në ripërsëritje formale të arsyeve fillestare dhe për të evidentuar veprimet e reja hetimore si "element i ri" i vlerësimit.
- Për masën e sigurimit "Arrest në shtëpi", të mbahet parasysh se zbatohen afatet e nenit 263 KPP (jo dyfishi sipas nenit 267/1), sipas standardit të konfirmuar nga vendimi nr. 40/2025 (Margjeka II).

- Për kërkesat me arsye shëndetësore, të mbahet parasysh nevoja për të mos e shpërfillur ekspertimin mjekoligjor pa caktuar ekspertim shtesë në rast mospajtimi, si dhe nenet 25/28 të Kushtetutës, jo vetëm neni 27 (qasje që del nga argumentet e pakicës në vendimin nr. 40/2024).
- Për masat e sigurimit të caktuara ndaj deputetëve, të mbahet parasysh interpretimi i konsoliduar: autorizimi i Kuvendit (neni 73/2 i Kushtetutës) kërkohet vetëm për masa që përbëjnë heqje lirie (arrest burg/shtëpi), jo për masa më të lehta, duke vlerësuar proporcionalitetin e çdo mase individualisht.
- Gjatë ndryshimit të cilësimit juridik të një fakti penal në shqyrtimin e masës së sigurimit, të mbahet parasysh që gjykata mbetet brenda faktit të paraqitur nga prokuroria dhe kufizohet në cilësimin juridik të tij (neni 229/2 KPP), ndërsa ndryshimi i akuzës i takon organit të akuzës.
- Në rastet kur përdoren kabina prej xhami/kafaze sigurie në seanca, të mbahet parasysh nevoja që të pandehurit dhe mbrojtësve t'u garantohet mundësi reale konsultimi konfidencial, si dhe që proporcionaliteti i kësaj mase të vlerësohet shprehimisht në raport me rreziqet konkrete të sigurisë të rastit specifik (vendimi 57/2026).
- Kur pranohen prova të reja të paraqitura nga prokuroria në apel (veçanërisht kur ajo nuk ka bërë ankim), të mbahet parasysh nevoja që mbrojtjes t'i garantohet kohë dhe mundësi reale, jo thjesht formale, për t'u njohur, konsultuar dhe kundërshtuar këto prova.

Për Gjykatën e Lartë

- Të shmangen konstatimet formale të tipit "nuk ka objekt", pa u shqyrtuar themeli i pretendimeve për shkelje lirie personale, edhe kur masa është shuar.
- Kur lind kontradiktë interpretimi mes trupave/kolegjeve të ndryshme, mund të konsiderohet referimi për vendim njësues, në vend që të mbeten në fuqi interpretime të kundërta (çështje e ngritur shprehimisht si pretendim në vendimin 40/2025).

- Kur trajtohen pretendimet mbi marrëdhënien mes regjimit të posaçëm të masave të sigurimit (neni 248 KPP) dhe dispozitave të përgjithshme të gjykimit në apel (nene 425-427 KPP), të jepet përgjigje shteruese dhe jo thjesht formale. Mungesa e sqarimit të plotë të kësaj marrëdhënieje ishte pikërisht shkaku i ndarjes trepalëshe të votave në vendimin nr. 57/2026.

Për vetë praktikën kushtetuese: çështje të hapura për debat

Analiza integrale e vendimeve të analizuara evidenton disa tema ende **pa** një përgjigje definitive nga shumica e Gjykatës, të cilat vazhdojnë të ngjallin debat kushtetues:

- Efekti i një vendimi pafajësie **jo** të formës së prerë mbi mundësinë e ricaktimit të masës së sigurimit (vendimi nr. 19/2023).
- Efekti i refuzimit (jo ende të formës së prerë) të ekstradimit mbi detyrimin për vazhdimin e paraburgimit (Vendimi nr. 51/2023).
- Nevoja e një standardi më rigoroz kontrolli kushtetues posaçërisht për “Arrest në burg”, krahasuar me masat më të lehta (vendimi nr. 19/2024, 7/2026).
- Kuadri i saktë kushtetues (neni 27 vs. nenet 25/28) për garancitë e trajtimit gjatë privimit të lirisë për arsye shëndetësore (vendimi nr. 40/2024).
- Kufijtë e saktë të pranimit të provave të reja në apel gjatë gjykimit të masave të sigurimit, dhe marrëdhënia mes nenit 248 KPP (regjim i posaçëm) dhe dispozitave të përgjithshme të gjykimit në apel (57/2026). Kjo çështje që **nuk** arriti shumicë vendimmarrëse.

* * *

Guidë e hartuar mbi bazën e analizës integrale të 17 vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (2022–2026); prej tyre 16 ankime kushtetuese individuale dhe vendimi nr. 39/2022 mbi kontrollin e kushtetueshmërisë së ligjit,

SQI

www.coe.int

Keshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE